



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 30 DHE 31 GUSHT 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 30 I 31 AVGUSTA 2012. GODINE**

**GUSHT - AVGUST
2012**

Rendi i ditës

1. Votimi i tekstit të mocionit të Interpelancës së ministres Mimoza Kusari-Lila, sipas kërkesës së grupit të deputetëve nënshkrues lidhur me vendimin e MTI-së për vendosjen e tarifës prej 35% për importimin e çimentos,
2. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media,
3. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pasurimin e miellit,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftime,
7. Shqyrtimi i Raportit të dytë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për integrim evropian për vitin 2012,
8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për vitin 2011,
9. Shqyrtimi i Raportit vjetor dhe pasqyrave të audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2011 dhe
10. Debat parlamentar lidhur me përdorimin e tri (3) kodeve të huaja telefonike në Kosovë, sipas kërkesës së deputetëve nënshkrues.

Dnevni red

1. Izglasavanje teksta mocije Interpelacija ministarke Mimoza Kusari-Lila, na zahtev grupe poslanika potpisnika u vezi odluke MTI o uspostavljanju tarife od 35% za uvoz cementa,
2. Prvo razmatranje N/zakona o korišćenju, administriranju i održavanju zgrada u suvlasništvu,
3. Razmatranje preporuke Komisije ad hoc za izbor kandidata za članove Odbora nezavisne Komisije za medije,
4. Razmatranje preporuka Ad hoc komisije za izbor članova Borda RTK-a,
5. Drugo razmatranje N/zakona o obogaćivanju brašna,
6. Drugo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama Zakona o ličnoj karti,
7. Razmatranje drugog izveštaja o planu delovanja Skupštine Kosova za evropske integracije za 2012. godinu,
8. Razmatranje godišnjeg izveštaja o radu regulativnog autoriteta za telekomunikaciju za 2011. Godinu,
9. Razmatranje godišnjeg izveštaja i revidiranih pregleda Trusta za penzijsku štednju Kosova za 2011 godinu, i
10. Parlamentarna rasprava u vezi upotrebe tri (3) strana telefonska koda na Kosovu, na zahtev poslanika potpisnika.

Seancën e drejton kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit ditës, të përgatitur nga Kryesia, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Kjo seancë është vazhdim i seancës të 13 dhe 14 korrikut 2012. Fillojmë me pikën e parë të rendit të sotëm të ditës:

1. Votimi i tekstit të mocionit të Interpelancës së ministres Mimoza Kusari-Lila, sipas kërkesës së grupit të deputetëve nënshkrues lidhur me vendimin e MTI-së për vendosjen e tarifës prej 35% për importimin e çimentos

Në ndërkohë, ministrja Mimoza Kusari Lila, më datën 25 korrik 2012, ka marrë vendimin për përfundimin e masës së përkohshme mbrojtëse të marrë nga vendimi numër 4508 të datës 11.6. 2012 të Ministrisë të Tregtisë dhe të Industrisë. Vendimi u është shpërndarë deputetëve dhe na duhet një votim formal.

Të pranishëm i kemi 91 deputetë.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Ismet Beqiri, kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar!

Së pari, sinjerisht unë nuk e kam marrë një vendim të tillë, një vendim, nuk e di. Edhe kolegët, sa e dimë, nuk e kanë marrë një vendim të tillë. Sidoqoftë, zoti kryetar për këtë pikë më lejo t'i them vetëm dy fjali.

Ajo që ka ndodhur në dy seancat e fundit, vërtet ka qenë e paprecedentë, një veprim shumë skandaloz dhe i papërgjegjshëm që e ka bërë Partia Demokratike e Kosovës dhe partnerët e koalicionit dhe gjithë ai presion e gjithë ato të vërteta që kanë qenë rreth atij vendimi, u dëshmuar më vonë, por jo me një arsyetim ose tentim arsyetim banal edhe qesharak të ministres, se nuk e ka bërë prej presionit, por e ka bërë prej vullnetit të mirë, që nuk qëndron. Është një e pavërtetë dhe shumë e madhe dhe si duket i kanë kryer ato punë, që i kam thënë edhe herën e kaluar, ajo dhe ata të tjerët që kanë qenë të involvuar, i kanë kryer bizneset e tyre.

Ajo që po e them në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, sigurisht na ka shqetësuar mënyra se si ka shkuar në dy seancat e fundit dhe për këtë dikush duhet të japë llogari. E kam fjalën për vendimin mbi tarifën, e pastaj mbi heqjen e saj. Kjo e dyta është normalisht për t'u përshëndetur, se tregon se vendimi i parë ka qenë i papërgjegjshëm, i paarsyeshëm dhe favorizues, pse jo, mund të thuhet se edhe ka favorizuar për të bërë veprime të paligjshme.

Ne si Lidhje Demokratike e Kosovës, normalisht tash e shohim se nuk ka bazë më që kjo pikë të jetë në rend të ditës, por sigurisht kam qenë i shtrënguar ta them në kuptimin

pozitiv, i shtrënguar dhe i detyruar, sepse më obligon edhe vota ime që e kam, edhe qytetare, edhe të gjithë kolegëve të mi deputetë këtu që janë të LDK-së. Them se ajo çfarë ka ndodhur nuk do të dëshironim më të përsëritet dhe ka qenë shembulli më i keq që di ta bëjë vetëm ky Kuvend, përkatësisht ky koalicion, e kësaj valleje i ka prirë ministrja, gjë shumë interesante. Vërtet unë po i them që AKR-ja kurrë nuk mund të jetë si LDK-ja. Pajtohem me të plotësisht.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka Emin Gërbeshi, por shkurt. Është propozues, por jo më shumë se 3 minuta, sepse debati ka përfunduar.

EMIN GËRBESHI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Më 11 qershor, MTI-ja mori vendim në kundërshtim me Ligjin për vënien e tarifës prej 35% ndaj çimentos së importuar që na detyroi ta thërrasim në interpelancë ministren e Tregtisë dhe Industrisë.

Në seancën e fundit e paraqitëm mocionin, por nuk arritëm të marrim një vendim në Parlament, sepse shumica e koalicionit qeverisës e braktisi sallën, duke krijuar mungesën e kuorumit dhe duke dëshmuar edhe një herë se në Kosovë nuk funksionon demokracia dhe sundimi i ligjit dhe se Kosova dhe populli i saj janë peng i grupeve të caktuara të interesit. E keqja më e madhe është se peng të këtyre interesave janë një pjesë e deputetëve, të cilët nuk po i mbrojnë interesat e qytetarëve, por janë vënë në shërbim të klaneve të caktuara. Kjo po e dëmton Kosovën, po e dëmton demokracinë dhe po na dëmton si komb. Jo pak vendime që ka marrë kjo Qeveri, disa politike dhe disa ekonomike, sidomos në privatizimin, kanë rënë në kundërshtim me interesat e Kosovës dhe qytetarëve të saj. Kështu ndodhi edhe me vendimin e MTI-së, i cili prodhoi efekte negative në ekonomi, sidomos në sektorin e ndërtimtarisë, krijoi monopol, e stabilizoi furnizimin e tregut dhe ngriti çmimet, e eliminoi konkurrencën në kundërshtim me ekonominë lirë të tregut dhe qarkullimin e mallrave dhe e gjithë kjo u bë për interesat e grupit të caktuar, pjesë e së cilës është edhe ministrja Kusari-Lila dhe të gjithë ata që e përkrahën, e që tani dihen publikisht. Për këtë arsye, ne e kundërshtuam një vendim të tillë dhe kemi kërkuar shkarkimin e ministres dhe kërkoj edhe tani, sepse fatkeqësisht viktimitë e këtyre interesave përsëri ishin qytetarët e Kosovës. Ky vendim u mor në kundërshtim me Ligjin pa paralajmërim, me një urgjencë tepër të çuditshme, duke e favorizuar vetëm një palë, në këtë rast kompaninë greke "Titan".

Qeveria ka pasur arsye të marrë vendime me urgjencë, sidomos për ta ndalur kontrabandën e naftës në pjesën veriore të Kosovës, e që është sektor i MTI-së, për ta vendosur rendin dhe ligjin në gjithë territorin e Kosovës, për t'i mbrojtur prodhimet bujqësore, prodhimet tjera, ose kur edhe sot digjen qindra hektarë pyje shekullore, Qeveria nuk e sheh të arsyeshme të marrë një vendim me urgjencë, por e sheh të arsyeshme të marrë një vendim me urgjencë për çimenton dhe me vendosmëri ta mbrojë atë vendim antikombëtar.

Ky vendim, përveç efekteve ekonomike, prodhoi edhe efekte politike, sepse u mor në kohën kur shkëmbimi tregtar me Shqipërinë po rritej dhe se kjo ishte ëndrra shqiptare, në kohën kur ne duhet të shkojmë drejt unifikimit të doganave, ku mallrat e dy vendeve duhet të trajtohen si mallra vendore dhe në kohën kur ne po kërkojmë të integrohemi me vendet tjera, vendosim barriera ndaj shtetit dhe kombit tonë.

Vendimi ishte kundër politikës gjeoekonomike të kombit tonë, duke i zhvlerësuar investimet në rrugën e kombit, ishte kundër ekonomisë kombëtare dhe vetë si vendim, shprehte qëndrimin antishqiptar të ministres dhe atë atyre që e përkrahnin. Ne e kundërshtuam këtë vendim, sepse ishte në kundërshtim me interesat gjithëkombëtare. E kundërshtuam edhe për një arsye të madhe, sepse ky vendim shprehte vetëm interesat e grupeve të caktuara të pangopshme që u pasuruan në kurriz të popullit të Kosovës, ku parandë shtetërore nuk e shohin si para të shenjtë, por si mundësi për t'u pasuruar. Ka pasur të drejtë apo jo ministrja Kusari-Lila...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputet, e ke harxhuar kohën. Fjalën e ka kërkuar kryetarja e Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Myzejene Selmani

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar dhe për të gjithë deputetët brenda seancës.

Duke besuar se ky sesion vjeshtor do të jetë më frytdhënës për qytetarët, kur dihet edhe rëndësia e deputetëve që janë për qytetarët e Kosovës, atëherë mund të themi se debati ka përfunduar për çështjen e interpelancës të sesionit të kaluar, ndërsa çështjet çfarë mund të jenë subjektet politike do të tregohen në të ardhmen. Ka mundësi që qytetarët e vlerësojnë se cili subjekt është ai i cili ecën në procese në Kosovë dhe cili është ai subjekt që i stopon proceset në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nëse e keni dëgjuar me vëmendje, edhe kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike tha se kjo çështje ka mbetur pa objekt, mirëpo seanca duhet të marrë vendim, do të thotë si të tillë ne e heqim nga rendi i ditës me një votim formal.

Kush është "për? Faleminderit! A ka kundër? Nuk ka. Prandaj, hiqet nga votimi i mëtejshëm.

I kemi pikat 2 dhe pikën 3, të cilat për shkak se ne duhet ta ndërpresim seancën, nëse jeni dakord, i lëmë për pasdite, në orën 14:00, apo kurdo që vazhdojmë.

A jeni dakord që t'i shtyjme për pasdite pikat 2 dhe 3? Kush është për? Faleminderit! A ka kundër? Një. Faleminderit. Do të thotë, pikat 2 dhe 3 shtyhen për pjesën e pasdites.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

E ftoj ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, zotin Dardan Gashi, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë Projektligjin.

MINISTRI DARDAN GASHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë të Kabinetit qeveritar,

Projektligji për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave në bashkëpronësi ka për qëllim rregullimin e të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësisë të pronarëve të njësive të ndërtesës në lidhje me shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve, hapësirave dhe pajisjeve të përbashkëta të ndërtesës.

Ky projektligj, përveç që zbatohet për të gjitha ndërtesat për banim që janë në pronësi të më shumë se një pronari, zbatohen edhe për komplekset e njësive individuale të banimit dhe afariste, të cilat e kanë në pronësi të përbashkët një territor.

Të nderuar deputetë,

Duke pasur parasysh edhe agjendën e ngjeshur sot, edhe faktin se Komisioni ka rekomanduar votimin e këtij ligji, nuk po e zgjas shumë dhe shpresoj se edhe ju do ta miratoni këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Është fjala për kryetarin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor. Kryetari nuk është këtu. Fjalën e ka kërkuar në emër të Komisionit, deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri

Domethënë në emër të Komisionit askush s'e do ka fjalën? Atëherë shkojmë sipas grupeve parlamentare.

Nga PDK-ja, a e ka dikush fjalën? Deputeti Nijazi Idrizi e ka kërkuar fjalën në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka trajtuar këtë projektligj si të tillë dhe mendon se mund ta kalojë këtë fazë. Ne do ta votojmë dhe në fazat e ardhshme do të merremi me këtë dhe do t'i japim rekomandimet e nevojshme për ta pasuruar këtë projektligj në mënyrën më të mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, fjalën e ka deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri.

AFËRDITA BERISHA SHAQIRI: Faleminderit, kryetar!

Qëllimi i Projektligjit për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi është që të rregullohen: të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e pronarëve të njësive të ndërtesës në lidhje me shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve së hapësirave dhe pajisjeve të përbashkëta të ndërtesës, bashkëpronësi në ndërtesë.

Projektligji gjithashtu parasheh kryerjen e veprimtarive të lejuara në njësitë e ndërtesës, por jo edhe masat ndëshkuese për veprimtaritë e palejuara. Kreu i tretë, i katërt dhe i pestë, precizojnë organet vendimmarrëse në ndërtesat e banimit edhe ndarjen e përgjegjësiave, administrimin dhe mirëmbajtjen e bashkëpronësisë së ndërtesës dhe mbikëqyrjen administrative.

Dispozitat e këtij projektligji nuk i cenojnë parimet themelore të legjislacionit të BE-së, si dhe është i bazuar në ligjet e vendeve të rajonit. Gjithashtu, ky projektligj nuk kërkon kosto shtesë që do të thotë nuk ka implikime financiare. Andaj, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, në parim e mbështet në lexim të parë këtë projektligj duke dhënë kontributin gjatë amendamentimit në Komision, sidomos në parashikimin e masave të atyre që uzurpojnë dhe shfrytëzojnë hapësirat e përbashkëta për qëllime personale. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, fjalën e ka deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka trajtuar këtë projektligj dhe ne do të votojmë për. Në përgjithësi, nuk kemi vërejtje të mëdha, përpos janë disa çështje që duhet sqaruar në lidhje me disa hapësira të përbashkëta.

Pra, duhet sqaruar se kur bëhet fjalë për ndërtesat, objektet shumë banesore, parkingjet dhe hapësirat e gjelbëruara mund të mos trajtohen si bashkëpronësi, por lidhja edhe projektimi i tyre në fillim kur ka qenë drejtpërdrejtë e lidhur me qytetarët që janë pronarë të atyre ndërtesave dhe rrjedhimisht fati i këtyre parkingjeve duhet të lidhet me qytetarët që do të banojnë në ato.

Sidomos këto gjëra duhet të definojnë këtu në këtë ligj, pasi kemi raste tani konkrete që shpeshherë hapësirat e caktuara përreth banesave me vendime të komunës apo në mënyra të ndryshme keqpërdoren, parkingjet mund të futen nën shfrytëzim të dikujt dhe ka pastaj hapësira në të cilat ndërtohet e zihen hapësirat e gjelbra e kështu me radhë.

Po ashtu, një element tjetër që duhet sqaruar te ky projektligj është çështja e hapësirave të përbashkëta në të cilat bashkëpronarët nuk kanë qasje, por ka qasje ta zëmë vetëm një bashkëpronar. Dhe, që të mund të jetë e shfrytëzueshme, pra po flas për hapësirat e shfrytëzueshme, do të duhej që të gjithë pronarët që mund t'i shfrytëzojnë duhet patjetër

të sigurohet qasja përmes hapësirave të një pronari të caktuar. Duhet të definohet kjo marrëdhënie e caktuar. Mund të përmendet tarracat apo sipërfaqet e ndryshme, hapësira në të cilat ka qasje vetëm një pronar apo një banesë e caktuar dhe ajo konsiderohet si hapësirë e përbashkët e të gjithëve dhe është e pamundur të bëhet shfrytëzimi i saj. Duhet të definohet pra pozita e këtyre hapësirave me ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të AAK-së, fjalën e ka deputeti Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit kryetar!

Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do t'i japë mbështetje këtij ligji në lexim të parë dhe gjithë kontributin do ta japim nëpërmjet Komisionit FunkSIONAL. Natyrisht se kemi vërejtje, por shpresoj se këto do të kapërcehen nëpërmjet Komisionit.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Sevdije Lama.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit! I nderuar zoti kryetar

Të nderuar deputetë,

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij ligji, Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re e përkrah këtë ligj dhe kontributin do ta japim në Komisionin përkatës. Faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të SLS-së, nuk ka të paraqitur. Në emër të Grupit 6+, deputeti Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit i nderuari kryetar,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupit Parlamentar 6+ e ka shqyrtuar Projektligjin për shfrytëzim, administrim dhe mirëmbajtje të ndërtesës në bashkëpronësi dhe do ta votojë këtë projektligj, ndërsa kontributin tonë do ta japim gjatë punës në Komision. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për debat nuk ka të tjerë interesuar. Votojmë tash!

Të pranishëm janë 88 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Konstatohet se me 70 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për shfrytëzimin dhe administrimin e mirëmbajtjen së ndërtesës në bashkëpronësi.

Kërkohej nga Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime. Do të thotë, 70 vota ishin me elektronikë, 4 pa kartela, 74 deputetë kanë votuar për.

Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pasurimin e miellit

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për pasurimin e miellit dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL nuk është këtu, prandaj fillojmë drejtpërdrejt me votimin e amendamenteve. Fillojmë me amendamentin e parë. Votojmë tash!

Amendamenti 1.

Kundër s'ka, abstenim s'ka.

Miratohet me 72 vota.

Amendamenti 2.

Kundër s'ka, abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër s'ka, abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër s'ka, abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër s'ka, abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër s'ka, abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër s'ka, abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër s'ka, abstenim s'ka.

Miratohet.

Dhe, tani e votojmë ligjin në tërësi. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se Kuvendi e miratoi Ligjin për pasurimin e miellit. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e 6 të rendit të ditës:

6. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftimin

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftimin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. E ftoj, në emër të Komisionit, deputetin Fatmir Xhelili, që ta marrë fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin,

Dhe të nderuar deputetë,

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë, në pajtim me nenet 57, 67 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit, e ka trajtuar Ligjin për ndryshim-plotësimin e letërnjoftimit dhe me amendamentet që i ka propozuar, i propozon Kuvendit që ta miratojë këtë ligj që do ta krijojë hapësirën ligjore, përkatësisht bazën ligjore që të prodhohen letërnjoftimet biometrike, që është një prej kritereve të Kosovës për procesin e liberalizimit dhe procesin e integritetit evropian, në mënyrë që edhe qytetarët tanë t'i kalojnë kufijtë eventuale vetëm me letërnjoftim biometrik, i cili do t'i mbajë të dhënat adekuate biometrike për qytetarët e Kosovës.

Faktikisht, i kisha propozuar Ministrisë Punëve të Brendshme që në të ardhmen t'i bëjë projektimet me kohë për shpenzimet buxhetore dhe t'i projektojë në kornizën afatmesme shpenzimet, në mënyrë që mos të bien ndesh me deficitet buxhetore që do të krijohen në fund të vitit për arsye se ky ligj nuk është paraparë për vitin 2012. Andaj, Komisioni i propozon Kuvendit që ta miratojë këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! I kemi në këtë rast dy amendamente. Amendamenti i parë, kemi dy propozime dhe si i tillë duhet të shkojmë me elektronikë.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Dua të intervenoj për shkak se me Grupin "6+" jemi pajtuar që neni i 9, 9.1. të mbetet sipas ligjit bazik për përdorimin e gjuhëve zyrtare, neni 9.2 të fshihet. Kështu që konsiderojmë se duhet të shkojë si një amendament që e përmenda, në pajtim me Grupin Parlamentar "6+".

KRYETARI: Faleminderit!

Atëherë, ka mbetur veç varianti i parë. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër s'ka, abstenim s'ka.

Miratohet.

Tash e votojmë ligjin në tërësi. Të pranishëm janë 82 deputetë.

Me 63 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftimin. Pika 7 e rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i Raportit të dytë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropian për vitin 2012

Komisioni për Integritet Evropian, në koordinim me komisionet tjera parlamentare, e ka hartuar dhe Kuvendi ia ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim Raportin e dytë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropian për vitin 2012.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Integritet Evropian, deputetin Lutfi Haziri, që në emër të Komisionit ta arsyetojë dhe prezantojë raportin para deputetëve të Kuvendit.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Kuvendi i Kosovës e ka miratuar Planin e Veprimit të tij për vitin 2012, në muajin dhjetor, si një dokument shumë të rëndësishëm që ka për qëllim përmbushjen e sfidave që dalin si rekomandime nga Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën.

Ky është plani i katërt me radhë, i cili është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës deri më tani, edhe pse kësaj here po e shqyrtojmë me vonesë për shkak të ndërprerjes së seancës të korrikut. Kuvendi i Kosovës për muajin prill 2012 e ka miratuar Planin e parë, apo raportin e parë për zbatim të Kuvendit që i ka paraqitur të arriturat e tremujorit të parë të vitit 2012, kurse tani para jush po miratohet ky plan që përfshin raportin në fakt të veprimit të Kuvendit të Republikës, i cili për të arriturat e kësaj periudhe parasheh dhe merr parasysh gjithmonë edhe tremujorin e parë apo detyrat e përcaktuara nga tremujori i parë i këtij viti.

Qëllimi i Planit të Veprimit është adresimi, siç thashë i sfidave të dala nga Raporti i Progresit për Kosovën, i cili zakonisht paraqitet në tetor të vitit kalendarik dhe konfirmon përkushtimin e institucioneve të Kosovës, respektivisht përmbushjen e agjendës evropiane dhe siguron përkushtim për përmbushje të kriterëve, të cilat ndahen në kritere politike, ekonomike dhe të standardeve evropiane. Kësaj here ky raport, angazhimet e Kuvendit për kryerjen e aktiviteteve si ligjvënës dhe mbikëqyrës ndaj trupave të Ekzekutivit dhe institucioneve të pavarura në bazë të detyrimeve që derivojnë nga Kushtetua e Republikës, si dhe përmbushja e detyrave të tij, siç janë dy rolet apo dy funksionet kryesore, thashë edhe më herët: ligjvënësia dhe mbikëqyrja.

Të gjitha këto obligime kushtetuese janë paraparë dhe janë të ndara në kolona që raporti i pasqyron në mënyrë të detajuar dhe është shpërndarë me kohë për të gjithë deputetët dhe grupet parlamentare. Komisioni për Integritet Evropian e ka rolin koordinues sa u përket aktiviteteve dhe përmbushjes së sfidave që përfshihen në Planin e Veprimit. Përveç kësaj, Komisioni ka mbajtur dëgjimet e rregullta me ministrat që janë kryesorë për çështjet, të cilat ndërlidhen drejtpërdrejt në procesin e integritetit evropian, në veçanti tash

në procesin e liberalizimit të vizave dhe në procesin e stabilizim-asociimit. Raporti i dytë për zbatim të Planit të Veprimit për këtë periudhë kohore ka nxjerrë këto rezultate. Nga gjithsej 222 sfida të Planit të Veprimit kanë qenë të ndara: 77 sfida, përfshirë kriteret politike, 26 sfida përfshirë kriteret ekonomike dhe 119 sfida përfshirë standardet evropiane.

Sfidat të cilat janë identifikuar për periudhën e tremujorit të parë janë gjithsej 65, prej të cilave janë adresuar gjithsej 44. Sfidat e identifikuar për periudhën e tremujorit të dytë nga gjithsej 128, janë adresuar 98, pra në total del se deri tani në këtë periudhë kohore të raportimit janë adresuar gjithsej 142 sfida, nga totali prej 222. Kuvendi i Republikës duhet që edhe më tutje t'i shtojë angazhimet e tij në funksion të mbikëqyrjes, në raportimin e ministrave duhet të jenë në baza të rregullta nga trupat e Kuvendit, përkatësisht nga komisionet parlamentare, po ashtu edhe ndaj institucioneve të pavarura.

Kuvendi i Republikës i ka miratuar ligjet që janë parakusht për procesin e liberalizimit të vizave, duke përfshirë këto ligje: Ligjin për azil, për menaxhimin e integruar të kufirit, kontrollin e kufirit shtetëror. Pritet sot të miratohet edhe Projektligji për letërnjoftimin biometrik, kurse edhe më tutje duhet angazhim për avancim të agjendës evropiane sa i përket legjislacionit. Kuvendi i Kosovës, më 28 prill të vitit të kaluar, me propozim të Komisionit për Integritet Evropian e ka miratuar rezolutën për angazhime të përbashkëta të Republikës drejt integritetit të Bashkimit Evropian, si një dokument shumë të rëndësishëm, i cili kërkon angazhim dhe përkushtim jo vetëm të Kuvendit, por edhe të gjitha institucioneve tjera në vartësi të Kuvendit të Republikës. Në takimin e katërt ndërparlamentar, të mbajtur më 19-20 maj, është nxjerrë po ashtu deklarata e përbashkët e Parlamentit Evropian dhe Kuvendit të Kosovës. Po ashtu, më 14 dhe 15 mars 2012, Deklarata e përbashkët e Parlamentit Evropian dhe e Kuvendit të Kosovës në takimin e pestë ndërparlamentar për perspektivën evropiane të Kosovës, si dokument i përbashkët në takimin e Strasburgut. Dhe, në fund, më lejoni që të ju bëj thirrje që të miratohet raporti i dytë për zbatim Planit të Veprimit dhe të vazhdojmë me dinamikën e realizimit të planit për këtë vit. Faleminderit!

KRYETARI: Po vazhdojmë diskutimet në emër të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike është lajmëruar deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah Planin e Veprimit të Kuvendit për integritet evropian për vitin 2012 dhe i fton të gjithë deputetët që ta votojnë këtë plan të veprimit.

Po ashtu, dua një falënderim për të gjitha komisionet parlamentare që e kanë kryer punën e tyre me korrektësi, e veçanërisht një falënderim i veçantë për Komisionin për Media, për Administratë, i cili ka treguar korrektësi të jashtëzakonshme gjatë të Planit të Veprimit. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të LDK-së s'ka të lajmëruar. Në emër të "Vetëvendosjes", deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Lëvizja “Vetëvendosje” ka vendosur ta votojë këtë plan, mirëpo i kemi disa vërejtje esenciale. Ky plan bëhet për t’i adresuar vërejtjet e Raportit të Progresit dhe në këto vërejtje një nga pikat më esenciale vazhdon të mbetet kontrolli parlamentar, kontrolli parlamentar i Qeverisë së Kosovës. Mund të themi që seanca e fundit ka qenë dëshmia më e qartë se çfarë kontrolli, çfarë dështimi ka Parlamenti. Parlamenti po dështon në mënyrë të vazhdueshme ta kontrollojë Qeverinë.

Kështu që kjo vazhdon të mbetet një nga pikat kryesore që do të duhej të përmirësohet dhe që lidhet drejtpërdrejt me punën e Kuvendit të Kosovës. Sa u përket arritjeve ose plotësimit të tyre të vërejtjeve, ka shumë ministri të cilat i kanë përmbushur disa nga vërejtjet, mirëpo ka edhe mjaft ministri të tjera që unë vetë personalisht kam konstatuar që ka pasur edhe raportime të rreme. Gjithsesi, ne do ta votojmë, por shpresojmë që në raportin tjetër këto gjëra të përmirësohen. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, fjalën e ka deputetja Suzan Novobërdali.

SUZAN NOVOBËRDALI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah raportin e dytë për zbatimin e Planit të Veprimit.

Unë dëshiroj t’i them edhe disa fjalë në emër të Komisionit. E shfrytëzoj rastin që, siç thatë edhe ju, raporti pasqyron punën e komisioneve dhe përmbushjen e pikave, të cilat dalin nga Plani i Veprimit. Në këtë raport mungojnë edhe dy pika, të cilat janë të realizuara nga Komisioni im, janë 19 dhe 74, mirëpo ne do t’i japim me shkrim në Komision dhe me përmbushjen e këtyre, plotësimin e këtij raporti me këto dy pika, ne edhe ashtu do ta votojmë, sepse është raport i mirë dhe real. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të SLS, kryetari i Grupit deputeti, Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIČ: Hvala, gospodine predsjedniče!

I Samostalna Liberalna Stranka je razmatrala plan delovanja Skupštine Kosova za evropske integracije, i mi čemo ovaj plan podržati i glasati za njega.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit “6+”, fjalën e ka deputetja Duda Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

I Parlamentarna Grupa “6+” takode podržava izveštaj i plan delovanja Skupštine Kosova za evropske integracije u 2012.godini, i glasaće za njega.

KRYETARI: Të paraqitur të tjerë për diskutim nuk ka, prandaj votojmë. Të pranishëm janë 73 deputetë. Votojmë tash!

Konstatohet se me 60 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi raportin e dytë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për integritet evropian për vitin 2012.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për vitin 2011

Raportin vjetor të Autoritetit të Rregullatorit të Telekomunikacionit për vitin 2011 e ka shqyrtuar Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim. Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për vitin 2011 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik. Nuk është këtu. E do dikush fjalën? Fjalën e ka kërkuar deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA- SHALA: Faleminderit!

Flas në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar Raportin e ART-së për vitin 2011 dhe mendon se ky raport i ka të gjitha të dhënat e nevojshme të fushës së telekomunikacionit për një vit, duke përfshirë: telefoninë celulare, telefoninë fikse, internetin, licencat e lëshuara, si dhe aktivitetet e kësaj agjencie.

Si raport i përmban të gjitha informatat e nevojshme. Megjithatë, ne si grup parlamentar mendojmë edhe pse raporti i vitit 2011 nuk i përmban informatat mbi realizimin ose jo të rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm nuk do të thotë se këto rekomandime nuk janë përfshirë, por mendojmë që herëve tjera të përfshihen edhe këto rekomandime se sa janë realizuar. E mbështetim raportin si grup parlamentar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Ju kërkoj falje për vonesën. Më lejoni të ju njoftoj se Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka trajtuar Raportin e Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit. Dëshiroj po ashtu të ju them që është ndër raportet më të kompletuara. Tanimë kemi të bëjmë me një prej agjencive së rregullatorëve mjaft të konsoliduara dhe kompetente në Kosovë.

Komisioni i ka trajtuar me hollësi të gjitha ato që janë thënë në raport dhe e ka dhënë miratimin e tij. Ne i lutim edhe grupet parlamentare, deputetët, që ta aprovojnë ose të votojnë për këtë raport. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Hashim Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: I nderuar, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar raportin vjetor të punës së Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, i cili e ka sjellë një raport mjaft voluminoz dhe me plot detaje rreth punës së vet dhe gjendjes në këtë treg.

Që në fillim do të them se ky raport mund të miratohet, ndonëse ka disa mangësi dhe paqartësi, të cilat do të ishte mirë të evitohen. Ato më shumë kanë të bëjnë me qartësimin e disa situatave dhe heqjen e konfuzionit që mund të krijojë.

Po i përmendi me radhë disa prej tyre:

Në faqen 19, ndër të tjera, thuhet se edhe gjatë vitit 2011, si rezultat i interpretimeve të ndryshme të dispozitave, ligjeve dhe praktikave për procedurat e përcaktimit të kufijve buxhetorë nga Ministria e Financave, ART-ja nuk ka mundur në mënyrë efektive ta realizojë dhe ta ushtrojë pavarësinë e plotë operationale dhe financiare. Rreth kësaj çështjeje nuk ka shumë detaje.

Cila është pengesa konkrete, cilat veprime janë ndërmarrë me qëllim të interpretimit të drejtë të ligjeve? Sa u kanë penguar ato në zhvillim, posaçërisht kur është në pyetje realizimi i projekteve të ndryshme zhvillimore. E them këtë, duke pasur parasysh faktin se plani financiar është përmbushur me një normë mjaft të ulët; ajo e buxhetit që është miratuar fillimisht është 50%, ndërsa e buxhetit të rishikuar 83,20%.

Në këtë rrafsh, më shqetësues është fakti se si investimet kapitale janë shpenzuar pak më shumë se 175 000 euro, ose vetëm 1/5 e shumës së planifikuar. Mungon përgjigjja se pse shkalla e shfrytëzimit të buxhetit është kaq e ulët, posaçërisht të shpenzimet kapitale.

Ka pasur probleme për realizimin e projekteve, apo kanë munguar projektet? Mos ART-ja ka qenë e penguar për përmbushjen e planeve? Pastaj sa është reflektuar në efikasitet mospërmbushja e tyre, por edhe në konsolidimin e tregut?

Dhe, në fund, mos ndoshta paaftësia për ta shfrytëzuar buxhetin ka ndikuar që ai të rishikohet, përkatësisht të shkurtohet nga 1,5 milion në 850 000 euro?

Investimet që kanë bërë operatorët në rrjet dhe në shërbimet telekomunikuese janë 26% më të larta se në vitin 2010. Nëse analizohen me kujdes tabelat dhe grafiket e paraqitura në raport, duket një ndryshim shumë i madh në strukturën e investimeve. Vjet 67,4% e tyre kanë qenë të orientuara në telefoninë mobile.

Dhe, krejt kjo është bërë në dëm të telefonisë fikse, e cila parvjet ka marrë afro 53% të investimeve, ndërsa vjet 10,4%.

Një strukturë e tillë e investimeve më bën të dyshoj mos ndoshta operatorët po heqin dorë nga ky shërbim, apo nuk kanë shumë interes për avancimin e tij.

Për këtë arsye, mendoj se edhe raporti është dashur të japë më shumë ilustrime se pse nuk janë atraktive investimet në telefoninë fikse dhe në aspektin afatgjatë të ART-së, i cili e trajton këtë problem.

Se ky sektor i telekomunikacionit është drejt degradimit tregojnë edhe shumë të dhëna. Numri i shfrytëzuesve të këtij shërbimi vjet, krahasuar me fundin e vitit 2010, ka rënë për 4 167 shfrytëzues, kurse norma e penetrimit është më e ulët në rajon.

Se ky shërbim mund të jetë fitimprurës tregon edhe fakti se numri i përdoruesve nga sektori i bizneseve vjet ishte gati dy herë më i madh se në vitin 2009, pa marrë parasysh se numri i përdoruesve individualë ka rënë për 11%.

Në raport nuk ka fare të dhëna rreth shfrytëzimit të kodit ndërkombëtar për telefoninë fikse, atë 0381. Sado që aty thuhet se trafiku hyrës ndërkombëtar merr mesatarisht 88% të thirrjeve, kjo nuk është e mjaftueshme. Do të ishte mirë sikur këtu të kishte të dhëna rreth vëllimit të hyrjeve dhe daljeve të këtij kodi, si dhe për mënyrën e kompensimit, përkatësisht të pagesave ndaj pronarit të këtij kodi. Në raport nuk përmendet sa paguhet kodi, të cilin e përdorim ne, edhe kodi fiks, po edhe kodi mobil. D.m.th. mungon informata se sa paguan Kosova për kodin mobil dhe atë fiks.

Kur është fjala për telefoninë mobile, do të ndalem vetëm në disa çështje që më duket se janë më kapitale.

Te mbulueshmëria ka disa shpërputhje, të cilat nuk janë sqaruar sa duhet. Në tremujorin e parë të vitit 2010, mbulueshmëria e popullsisë ishte 99,5%, ndërsa e territorit 91,35%, sado që në muajt në vijim, shkalla e mbulueshmërisë së popullsisë mbetet e njëjtë, përkatësisht me ndryshime të parëndësishme, rreth 88,5% dhe e tillë është që nga tremujori i dytë i vitit 2010, prej nga vjen edhe ky ndryshim. Mos kjo ndërlidhet me problemet e pranishme në veri të vendit, që njëkohësisht flet edhe për pamundësinë e kontrollit të tregut.

Meqenëse jemi në fazën e procesit të privatizimit të Postës dhe të Telekomit të Kosovës, do të ndalesha pak në sektorin, i cili pas privatizimit mbetet në pronësi publike. Fjala është për një treg postar, i cili është i pamargjinalizuar në krahasim me shërbimet tjera të telekomunikimit. Vjet ky treg, 63,5% të të cilit e kontrollon PTK-ja, ka gjeneruar vetëm 3,2 milionë euro të hyra, i cili sado që ka një rritje të lehtë, megjithatë mbetet larg parametrave që u arritën në fushat tjera dhe pikërisht në shërbimet postare të PTK-së ka rënie më të madhe. Sipas këtyre të dhënave, pas përfundimit të procesit të privatizimit, Qeverisë së Kosovës do t'i mbetet sektori më problematik, më pak i zhvilluar dhe që po e humb tregun në raport me operatorët tjerë privatë. Sado që kjo nuk mund të ndërlidhet në mënyrë direkte me punën e ART-së, megjithatë Qeveria apo edhe ky autoritet duhet ta kenë të qartë vizionin për funksionalizimin e shërbimeve postare, ose ai do të mbetet barrë e Buxhetit të Kosovës, derisa pjesa në pronësinë publike të shuhet tërësisht.

Dhe, në fund, kërkoj nga deputetët që këtë raport të punës të Autoritetit Rregullativ ta votojnë dhe lus deputetët edhe një herë që ta votojnë raportin. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, fjalën e ka Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta miratojë këtë raport. Mendojmë se është një raport, i cili ka goxha shumë të dhëna, për të cilat duhet të besojmë se vijnë nga një autoritet zyrtar.

Mirëpo, janë edhe disa vërejtje për atë se si paraqiten të dhënat dhe nganjëherë edhe mangësia në qartësinë e të dhënave. Shumë prej tyre u përmendën këtu, prandaj nuk kisha dashur t’i përsëris. Unë dua të ndalem në dy apo tri çështje, që mendoj se duhet të përmenden për të dhënat që dalin nga raporti, jo për ta kritikuar mënyrën se si janë paraqitur, por për ta diskutuar një realitet që e kemi sot në tregun e telekomunikacionit, veçanërisht të telefonisë.

Meqenëse, siç u tha edhe nga parafolësi, jemi duke hyrë në një proces të privatizimit të PTK-së dhe, në anën tjetër, disa prej arsyetimeve që dalin nga Qeveria për privatizimin e PTK-së, raporti i dëshmon si të paqena, pra si të pavërteta.

Njëri prej arsyetimeve, që vazhdimisht është përdorur nga Qeveria e Republikës së Kosovës si arsyetim për privatizimin e telefonisë, është humbja e tregut, pra mungesa e aftësisë së Valës dhe telefonisë fikse në pronësi publike, për të konkurruar me operatorin e dytë, i cili është IPKO, në këtë rast, pra një kompani tjetër publike, jo e Kosovës, por e Sllovenisë, që operon në territorin e Kosovës.

Dhe, nëse i shohim të dhënat e paraqitura në faqen 38, pra për ndarjen e tregut ndërmjet këtyre dy operatorëve, por edhe dy operatorëve tjerë virtualë, atëherë shihet që në fakt nuk është se Vala e ka humbur tregun si rrjedhojë e mungesës së aftësisë për të konkurruar me IPKO-n. Pra, e shohim që atë pjesë të tregut, një pjesë natyrisht që e ka marrë IPKO dhe kjo nuk duhet të diskutohet, mirëpo një pjesë të konsiderueshme të tregut që e ka humbur Vala, me kalimin e viteve, në fakt, ia ka marrë Z-Mobile. Pra, ia ka marrë një operator virtual nëpërmjet një kontrate të dyshimtë, në të cilën ka qenë e përfshirë edhe Qeveria e Kosovës, e dyshohet edhe vetë kryeministri, i cili e ka dëmtuar drejtpërdrejt tregun dhe kompaninë e Postës dhe Telekomit të Kosovës. Pra, kjo tregon që është edhe një prej indikatorëve, që është një indikator goxha i rëndësishëm në krejt këtë fushatë zhvlerësimi të projektuar të Postës dhe Telekomit të Kosovës për ta arsyetuar privatizimin, dhe për ta arsyetuar privatizimin e lirë.

Po ashtu, mendoj se në raport mungon një e dhënë, e cila është shumë e rëndësishme për publikun dhe për konsumatorin e telefonisë mobile. Është e dhëna e cila e problematizon tarifimin që e bëjnë këto kompani, jo në ofertat që ua japin konsumatorëve apo klientëve të tyre drejtpërdrejt, mirëpo tarifat që i caktojnë për transaksione apo për komunikacionin ndërmjet operatorëve.

Pra, çfarë tarifash u cakton IPKO-ja thirrjeve nga Vala dhe anasjelltas për shkak se këto ndikojnë goxha shumë në çmimin e impulseve, por edhe SMS-ave që dërgohen ndërmjet dy valëve, për shkak se natyrisht është një mundësi goxha e madhe, që po qe se ART-ja nuk është aktive në këtë drejtim për ta garantuar një çmim të leverdishëm për konsumatorin, atëherë do të jetë në interes të kompanive, që çmimin apo tarifën për këtë transaksion ndërmjet operatorëve ta mbajnë shumë të lartë, në mënyrë që t'i mbajnë apo t'i kushtëzojnë klientët e tyre ta mbajnë numrin përbrenda kompanisë, pra për ta pasur thirrjen më të lirë me personat tjerë, të cilët e përdorin më shumë komunikimin elektronik.

Dhe, në këtë drejtim, ne konsiderojmë që këtu, të paktën në raport, nuk është thënë mjaft për atë se çfarë tarifash janë, e aq më pak është thënë për atë se çfarë bën ART-ja për ta mbrojtur këtë pjesë të tregut, se kjo është pjesë e konsiderueshme dhe shumë e rëndësishme e tregut dhe e komunikacionit të telefonisë, në përgjithësi, në Kosovë.

Dhe, çështja e tretë, që po na sillet vit pas viti, edhe në këtë raport, mungojnë informatat e qarta për atë se deri në çfarë mase po e dëmton tregun e Kosovës dhe telefonisë së Kosovës, në përgjithësi, ndërhyrja e operatorëve ilegalë dhe çfarë po ndërmerr ART-ja për ta mënjeluar këtë ndërhyrje. Pra, ne e dimë që pas një operacioni të shkurtër, i cili e pati një efekt të menjëhershëm, mirëpo pastaj u zmbraps nga ky operacion i ART-së shumë vite më parë, nuk ka pasur më, ose të paktën nuk është folur më në publik për ndonjë operacion tjetër për t'i parandaluar ndërhyrjet e operatorëve ilegalë në territorin e Kosovës, veçanërisht ata që vijnë nga Serbia dhe të cilët kanë antena në territorin e Kosovës dhe të cilët ofrojnë ilegalisht shërbime të telefonisë mobile këtu. Pra, në raport nuk thuhet asgjë për këtë çështje dhe injorimi i kësaj çështjeje nga ART-ja mendojmë që nuk është as i drejtë, e madje nuk është as i lejueshëm, për shkak se ART-ja është përgjegjëse për ta rregulluar tregun e telefonisë në Kosovë dhe telekomunikacionin, në përgjithësi.

Ndërkohë, kjo ndërhyrje në tregun e telekomunikacionit në Kosovë i dëmton operatorët e vendit, por i dëmton edhe konsumatorët e vendit, e rrjedhimisht në këtë drejtim ART-ja po dështon ta kryejë punën e vet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të AAK-së, fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Kolegë deputetë,

Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e ka lexuar me vëmendje raportin e ART-së dhe mendoj se në këtë raport nuk janë përfshirë çështjet kryesore, me të cilat ART-ja duhet të merret, sidomos nuk është përcaktuar se sa humb Kosova financiarisht në këtë aspektin e telefonisë mobile dhe të operatorëve ilegalë, që veprojnë këtu.

Prandaj, për këtë raport, ne do të abstenojmë si grup parlamentar. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, fjalën e ka kryetarja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar raportin vjetor të punës së Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin 2011.

Duke marrë parasysh se këto raporte vijnë edhe në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në bazë të Ligjit për telekomunikacionin, tash ndoshta me të renë Ligjin për shërbime postare, mund të themi se raporti është punuar në bazë të ligjit, mirëpo në rast se i shohim politikat e Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, atëherë mbetet të dëshirojmë në të ardhmen që ky autoritet, së bashku me stafin e tij edhe profesional, edhe administrativ, të shkojë në drejtim të duhur dhe të punojë në drejtim të politikave të telekomunikacionit, për arsye se mbetet për t'u dëshmuar akoma puna e tij si autoritet.

U theksua nga shumë parafolës këtu se kemi edhe humbje, apo më mirë të themi evazion fiskal nga operatorët ilegalë, të cilët e shfrytëzojnë rrjetin tonë në Kosovë, mirëpo mbetet që në të ardhmen vetë Qeveria dhe ne si Kuvend të përpiqemi që ndoshta edhe Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit t'ia sjellim edhe atë pjesën më të mirë - që të jetë shumë i pavarur të punojë. Mirëpo, çështja se si do të punojnë këta për çështjet e kodeve telefonike, që u theksua këtu pak më herët, duhet të kemi kujdes se çështja e kodeve telefonike është më shumë politike, në të cilën ndoshta duhet të gjithë të punojmë, që Kosova të mos ketë humbje dhe të mos u paguajmë njerëzve tjerë, kur dihet se roli i Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit është si rregullator për të gjitha shërbimet postare, shërbimet telefonike, shërbimet e internetit, të cilat ekzistojnë në Kosovë.

Me një fjalë, mund të themi se Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit prapëseprapë është munduar të punojë në vitin 2011 me një performansë pak më të mirë se në vitet tjera, mirëpo mbetet që në të ardhmen ky autoritet të punojë në bazë të ligjit dhe, në bazë të ligjit, atëherë edhe vetë konsumatorët e Kosovës, ne që jemi konsumatorë, do të thotë qytetarët e Kosovës, të jenë të kënaqur me shërbimet postare, shërbimet e telefonisë dhe të jenë të kënaqur me largimin e operatorëve ilegalë në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga grupet tjera nuk ka të paraqitur. Fjalën e ka deputetja Safete Hadërgjonaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e datës 12 qershor, e ka shqyrtuar raportin e Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit dhe ka ardhur në përfundim që pjesa që ka të bëjë me pjesën e financave nuk është e plotësuar ashtu siç duhet, për çka ka kërkuar nga Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit, që t'ia sjellë pjesën që ka të bëjë me detajizimin e çështjeve që kanë të bëjnë me financat, për arsye se ka qenë shumë i grumbulluar dhe pa të dhëna të detajuara, ashtu siç e parasheh Ligji i Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, edhe Ligji për financat publike.

Kështu që Komisioni, në takimin e parë e ka refuzuar dhe ka kërkuar që ky autoritet rregullativ të sjellë raport plotësues, në të cilin do të paraqiten të dhënat e detajuara se si

është planifikuar dhe si është shpenzuar buxheti dhe po ashtu ka kërkuar që t'i paraqesë shpenzimet brenda kategorive dhe nënkategorive ekonomike, që i kanë munguar raportit final.

Pasi Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit e ka sjellë raportin e detajuar më datën 26.6.2012, Komisioni e ka shqyrtuar raportin financiar të ART-së, me ç'gjë është vërejtur që buxheti i ART-së ka qenë i planifikuar 1.592.474,00 euro, nga e cila shumë e planifikuar janë shpenzuar vetëm 804.487,00 euro, apo buxheti ka qenë i shfrytëzuar 50,52%. Për paga dhe mëditje është shpenzuar 99,57%, për mallra dhe shërbime 78%, për shpenzime komunale 68,89%, kurse nga kategoria e shpenzimeve kapitale, nga 875.000 euro të planifikuara janë shpenzuar vetëm 179.826, që do të thotë se janë shpenzuar vetëm 20,56%.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ia ka bërë disa vërejtje këtij autoriteti rregullativ, ku ka qenë i pranishëm edhe udhëheqësi i këtij autoriteti, në lidhje me shpenzimet brenda nënkategorive, sepse në disa raste është tejkaluar ajo që është planifikuar me atë që është shpenzuar.

Dhe, një vërejtje të veçantë e ka pasur në lidhje me shpenzimet kapitale, të cilat janë vetëm 20,56% nga ajo që është planifikuar, kurse ky autoritet rregullativ, me rastin e planifikimit të buxhetit, vazhdimisht na bën presion të vazhdueshëm se nuk po ndajmë mjete të duhura për këtë institucion për t'i realizuar projektet e veta kapitale dhe disa herë edhe në Raportin e Progresit është deklaruar se duhet të ketë mjete të mjaftueshme financiare, kurse kur është çështja të realizimi i mjeteve, sidomos në pjesën që ka të bëjë me investimet në këtë sektor, atëherë kemi ngecje të mëdha.

Megjithatë, Komisioni për Buxhet dhe Financa, pas këtyre vërejtjeve që ia ka bërë këtij autoriteti, e ka miratuar raportin, meqenëse, pas plotësimeve të cilat janë bërë, i plotëson kushtet për raportim.

Prandaj, i ftojme deputetët që edhe këtë pjesë ta miratojnë.

Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Zoti Ali Sadriu e ka fjalën.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar!

Deputetë të nderuar,

Raporti i vitit 2010 i ART-së ka qenë një raport shumë i keq dhe ka qenë një brengë për Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Kemi pasur disa takime dhe si rezultat apo fryt i të gjithave vjen deri te ajo që Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike i kërkon Zyrës së Autoritetit Gjeneral të bashkëpunojë më për së afërmi gjatë vitit 2011. Një veprim i tillë ka ndodhur, prandaj e vërejmë një përmirësim të dukshëm karshi raportit të vitit 2010.

Megjithatë, ne vërejmë disa mangësi që dua t'i theksoj, e që duhet të jenë brengë dhe sfidë për ART-në, që gjatë këtij viti t'i tejkalojë edhe këto pengesa.

Në disa raste nuk ka aplikuar nënshkrimin e paraparë me ligj për vonesat me pagesat për operatorë. Janë iniciuar prokurime, të cilat nuk ishin planifikuar në buxhet. Ka pasur raste kur prokurimi është kategorizuar nën kodin e shërbimeve tjera kontraktuese, në vend të kodit të projektuar si investime kapitale.

Akt-emërimet e punonjësve nuk e përmbajnë nivelin e pagesës, si element kyç i marrëdhënies kontraktuale. Nga menaxhimi jo i mirë i projekteve të iniciuara me prokurim, nuk është prezantuar gjendja reale e pasurisë. Disa pasuri ishin të regjistruara si të ruajtura në depo. Praktikisht, ato gjenden në përdorim në kohë të caktuar.

Mungon dizajni i duhur për auditimin e brendshëm.

Si konkluzion: Me gjithë progresin në disa fusha të caktuara të menaxhimit më të mirë të financave dhe kontrollit, ende janë të pranishme mjaft mangësi. Me theks të veçantë - kontrolli, nuk është funksional në fushën e menaxhimit të prokurimit, menaxhimit të pasurisë, burimeve njerëzore, arkëtimeve, performansës së shfrytëzimit të buxhetit, veçanërisht të atyre për shpenzime kapitale.

Prandaj, Bordi dhe kryetari i Bordit të ART-së kanë arritur ta menaxhojnë institucionin në harmoni me kërkesat e menaxhimit të financave dhe kontrollit vetëm në disa fusha të caktuara.

Në këtë kontekst, Bordi dhe kryetari i Bordit të ART-së gjithsesi duhet të bëjnë përpjekje të vazhdueshme, në mënyrë që ta forcojnë kontrollin për t'i parandaluar mangësitë e identifikuara, në mënyrë që të sigurojnë plotësisht mjedis të duhur të kontrollit dhe menaxhim efikas të pasurisë, që e kanë në dispozicion. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Vazhdojmë me votimin e raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për vitin 2011.

Në sallë janë 66 deputetë. Votojmë tani!

Nga votimi, 41 janë për, 9 abstenime dhe 3 kundër. Konstatohet se Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për vitin 2011.

Pika e nëntë e rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i raportit vjetor dhe pasqyrave të audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale në Kosovë për vitin 2011

Komisioni Funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, e ka shqyrtuar raportin vjetor dhe pasqyrat e arritura të Trustit të Kursimeve Pensionale për vitin 2011 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor të Trustit të Kursimeve Pensionale për vitin 2011 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Ftoj për diskutim kryetarin e Komisionit Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike, zotin Sadriu, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

Zotit Ali Sadriu e ka fjalën.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar këtë raport dhe e ka pasur një seancë dëgjimore me Bordin e Trustit të Kursimeve Pensionale dhe me drejtorin menaxhues. Bashkërisht i kemi shqyrtuar dhe shpalosur një për një të dhënat e prezantuara në raport. Kemi pasur kënaqësinë që përgjithësisht ta gjejmë një raport të mirë, të adresuar mirë dhe të plotësuar në harmoni me dispozitat ligjore.

E kam kënaqësinë që për herë të parë Trusti, me punën e vet, e bën një efikasitet më të mirë të menaxhimit të pasurisë jashtë, me gjithë limitet që ka. Dhe, e ka një performansë pozitive nga vitet paraprake.

Megjithatë, si qytetar i Kosovës, si pjesëmarrës në Trustin e Kursimeve Pensionale, i shqetësuar nga norma e lartë e inflacionit, i prezantuar në vitin 2011 - 7,3, norma e kamatës që obligojnë dispozitat ligjore, me gjithë vullnetin dhe dëshirën edhe të Trustit, bëjnë që mjetet tona efektivisht ta humbin vlerën e vet.

Është një çështje, për të cilën Kuvendi do të duhet të mendojë, edhe për ndryshimin e atij ligji dhe specifikimin karshi rrjedhave që i kemi në tregun botëror, por edhe nevojat në Kosovë.

Mendimi ynë është që ato mjete, në një masë shumë më të madhe, do të duhej të ishin të pranishme në Kosovë, e jo jashtë. Arsyeja që ato të mbeten jashtë tani veç është banalizuar, sepse në Kosovë kemi projekte që lidhen me fatin e shtetësisë sonë dhe shtetit tonë, prandaj mendimi ynë profesional është se shumë më e logjikshme dhe shumë më e arsyeshme ka qenë dhe do të jetë që ato mjete të investohen në ato investime ku, sipas bindjeve tona profesionale, nuk ka asnjë arsye për frikë se rrezikohet ai investim, përkatësisht ato të mira materiale. Përkundrazi, ato gjenerojnë, pra është përgjithësisht pengesë. Do të shihja ligjin me të cilin operon Trusti i Pensioneve, karshi efektit më të mirë edhe për pjesëmarrësit në skemën pensionale, por edhe për vetë zhvillimin e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetarja e Komisionit për Buxhet e Financa, Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!
Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet e Financa është Komision FunkSIONAL në shqyrtimin e Raportit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, kështu që më datën 12.6.2012 e ka shqyrtuar raportin vjetor të Trustit të Kursimeve Pensionale për vitin 2011 dhe ka vlerësuar se raporti është në pajtim me Ligjin për fondet pensionale të Kosovës dhe i njëjti përmbush obligimet ligjore për raportim.

Raporti përmban vlerën dhe proporcionin e mjeteve pensionale, të cilat janë investuar në klasa të veçanta, duke përfshirë hollësi të dhënësve të veçantë të letrave me vlerë dhe raportet vjetore për të gjitha pagesat, përfshirë pagesat e mbajtjes dhe pagesat tjera për shërbimet dhe transaksionet financiare.

Raporti përfshin po ashtu informata për organizimin dhe funksionimin e Trustit, sistemet pensionale, financimin dhe shpenzimet e Trustit, kontributet dhe kontribuuesit, tërheqjen e kursimeve pensionale, operacionet e Trustit, kufizimet ligjore për investime, raportet e Auditorit të Jashtëm për operacionet e Trustit, si dhe mjetet pensionale të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Trusti i Kursimeve Pensionale posedon mjete nën menaxhim me vlerë prej 595 milionë euro. Kryesisht këto mjete investohen në aksione të sigurta, të cilat kanë një rrezikshmëri më të ulët dhe është raportuar se gjatë vitit 2011, përkundër gjendjes së vështirë që ka mbretëruar në tregjet financiare, viti është përmbyllur me fitim bruto prej 3,3 milionë euro.

Vlera e mjeteve është rritur si rezultat i kontributeve të reja të paguara dhe performansës së investimeve.

Trusti ka vazhduar të shpërndajë pensione për kontribuuesit e vet 7 milionë euro, ose rreth 1 milion euro më shumë se një vit më parë dhe që nga themelimi deri më sot është raportuar se Trusti ka shpërndarë pensione në vlerë prej 19,5 milionë euro.

Numri i të pensionuarve është rritur. Pensionistë të rinj janë 2 868, nga 2 700, sa ishin një vit më herët.

Investimi i mjeteve të Trustit është bërë në bazë të politikave investive të Bordit udhëheqës.

Trusti gjatë vitit 2011 e ka ndryshuar politikën e investimeve ,duke vendosur në strategjinë e re të investimeve deri në 40% të mjeteve në tregun e aksioneve dhe deri në 60% në instrumente financiare apo letra me vlerë, me kthim absolut.

Meqenëse në treg, në klasa të ndryshme të aseteve mund të ketë rënie dhe klasa tjetër rritje, kjo që është bërë ka pasur për qëllim ruajtjen e strukturës së përgjithshme të mjeteve të investuara, minimizimin e riskut dhe krijimin e baraspeshës.

Shumica e instrumenteve nëpërmjet të cilave investon Trusti, më saktësisht 6 nga 9, kishin performansë pozitive të kthimit në investime në vitin 2011.

Sa u përket investimeve në Kosovë, Trusti ka qenë i pranishëm në investime në depozitat e dy bankave në vend - Raiffeisen Bank me 15,8 milionë euro, dhe në NLB Prishtina, me 15,8 milionë euro.

Me miratimin e Ligjit është hapur mundësia që një pjesë e mjeteve të investohen në bonot e emetuara nga Qeveria, apo në bonot e brendshme financiare të vendit.

Komisioni është informuar se Bordi po e shqyrton mundësinë e plasimit të mjeteve në këto instrumente financiare në maturitet afatgjatë në tregun financiar të Kosovës dhe rezultatet mbeten të shihen në raportimet tjera.

Trusti i Kursimeve Pensionale i realizon aktivitetet e veta nëpërmjet financimit nga taksa menaxhuese, e miratuar nga Kuvendi, në vlerë prej 0,65%, e cila në vitin 2011 është zbritur në 0,60%.

Shpenzimet e Trustit ndahen në dy grupe kryesore, shpenzimet e investimeve dhe shpenzimet operacionale. Shpenzimet e investimeve janë të pashmangshme. Transferet e mjeteve prej BQK-së për në tregjet financiare, që e kanë koston e vet, ndërsa menaxhuesit e instrumenteve për investime të hapura nëpërmjet të cilave Trusti investon mjete pensionale, po ashtu e ngarkojnë tarifën e vet menaxhuese për investimet e Trustit.

Në vitin 2011, 69% nga taksat kanë shkuar për shpenzime investive, kurse shpenzimet operacionale përbëhen nga zëra të zakonshëm, si në çdo organizatë tjetër, që janë: pagat, qiraja, mirëmbajtja, shpenzimet, komunikimet e tjera, kështu që në vitin 2011, 31% nga taksa kanë shkuar për shpenzime operacionale.

Komisioni, përveç se e vlerësoi raportin të përgatitur mirë, të detajuar dhe se përmban kërkesa ligjore për raportim, sugjeroi që Trusti i Kursimeve Pensionale, në aktivitetet e ardhshme, në pajtim me ligjin dhe në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, të bëjë zgjidhjen e shumës prej 19 milionë e 320 mijë eurove, të pidentifikuara në emër të kontribuuesve dhe me qëllim të identifikimit të pronarëve të vërtetë të këtyre mjeteve dhe të deponimit të kontributeve në emër të tyre.

Përndryshe, në këtë mënyrë siç është paraqitur këtu dhe çfarë ka ndodhur deri më tash, këtu qytetarët të cilët kanë paguar në Fondin e Trusteve të Kursimeve Pensionale janë të dëmtuar për këtë shumë.

Po ashtu, u sugjerua që Trusti të mendojë që brenda rregullativave ligjore, mundësinë e krijimit të një mënyre të veçantë për punëtorët që dalin në pension, në mënyrë që të mos ndikohen direkt nga krizat financiare dhe rënia momentale e aksioneve, si dhe meqë është krijuar baza ligjore, Trusti të investojë më shumë në mjete në tregun financiar në Kosovë, e që do të ishin input për zhvillimin ekonomik të vendit.

Meqenëse raporti që na është prezantuar i ka përmbushur kushtet për raportim, sipas ligjeve në fuqi, atëherë Komisioni për Buxhet e Financa e ka miratuar dhe rekomandon miratimin e tij.

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Dibra e ka fjalën.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar dhe analizuar Raportin vjetor në pasqyrat e audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale për vitin 2011.

Në raport janë pasqyruar aktivitetet dhe ngjarjet kryesore të vitit, si nga pjesa e investimeve, ashtu edhe nga ajo e operacioneve.

Tek operacionet, Trusti arriti rezultate të mira, ku gjatë vitit 2011 arkëtoi nivel rekord të kontribuuesve pensionalë prej 108 milionë eurove, që gjithsej vlera e fondit nën menaxhim të Trustit Pensional arriti në 595 milionë euro. Po ashtu, e zvogëloi taksën menaxhuese, e cila është për t'u inkurajuar, por mendojmë se kjo taksë në të ardhmen duhet të zvogëlohet edhe më tutje.

Sa i përket fushës së investimeve, Trusti e realizoi një kthim bruto në vlerë prej 3,3 milionë euro, përkundër krizës financiare që ka qenë dhe vazhdon të jetë në vendet e Evropës.

Konsiderojmë se menaxhimi i fondeve të Trustit Pensional ka qenë i suksesshëm, krahasuar me vendet e rajonit, që kanë pasur kthim negativ në investime, siç kanë qenë Kroacia dhe Bullgaria. Megjithatë, mendojmë se menaxhmenti edhe më tutje duhet të jetë vigjilent në menaxhimin e fondeve të Trustit Pensional, duke pasur parasysh turbulencat në tregjet financiare evropiane dhe më gjerë.

Edhe gjatë vitit 2011, Trusti nuk ka arritur të bëjë shpërndarjen e shumës prej 19 mijë e 320 eurove në llogaritë e kontribuuesve individualë. Kjo është cekur si theksim i çështjes edhe në raportin e Auditorit.

Siç e ceka edhe në fillim të raportit vjetor të Trustit, i është bashkëngjitur edhe raporti i Auditimit, ku sipas opinionit të auditorit pasqyrat financiare të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës e paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale pozitën financiare, prandaj Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës do ta votojë raportin dhe fton edhe deputetët tjerë ta votojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga LDK-ja, zoti Naser Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues! Pushimi, siç po duket, ka qenë shumë i gjatë.

E kemi shqyrtuar raportin dhe kemi qenë të përgatitur që qysh në seancën e kaluar ta japim kontributin në mënyrë më të detajuar lidhur me shifrat e mjeteve financiare të Fondit Pensional, por meqenëse ka kaluar një kohë, gati 9 muaj u bënë që është bërë përpunimi i këtyre shënimeve, unë si përfundim do ta jap mendimin e deputetëve të

Grupit Parlamentar të LDK-së, që është njëri nga raportet më të mira të prezantuara deri më sot nga ish-Trusti, tani Fondi Pensional, dhe konsiderojmë se mjetet të cilat janë të plasura në formë të aksioneve ose të plasura si depozita në bankat ndërkombëtare të njohura, kam për qëllim kryesor të sigurohet që vlera nominale e atyre mjeteve të mos humbë, dhe kjo është përgjegjësia kryesore e Fondit që konsideroj se është arritur në këtë raport. Konsideroj se përparimi në ndryshimin e Ligjit për Fondin Pensional, që ka të bëjë me plasmanin e mjeteve të trustit në tregun e Kosovës, është një përparësi, por ajo krejt varet nga niveli i aftësisë së tregut dhe zhvillimit ekonomik të tregut të Kosovës që t'i absorbojë ato mjete, por meqenëse presim që të ketë progres dhe rritje të ekonomisë së Kosovës, ne do të angazhohemi që dalëngadalë ky ligj të jetë konform asaj që deklaruan edhe deputetët tjerë.

Në përgjithësi, raporti i Fondit Pensional meriton që të aprovohet për vitin 2011. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, deputetja Albana Fetoshi.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryesues!

Raporti i Trustit për vitin 2011 është veç vazhdim i avazit të vjetër të menaxhimit të investimeve pensionale të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Pra, ky raport është pasqyra më e mirë e performansës së Trustit për gjithë kohën e operimit të tij dhe dështimeve të këtij institucioni, por edhe qasjes ndaj sistemit pensional për këto dhjetë vjet.

Të nderuar deputetë,

Tashmë janë mbushur 10 vjet prej kur me rregulloren e UNMIK-ut 2001/35, është vendosur një sistem pensional në Kosovë, një sistem tjetër pensional nga ai i gjeneratave, pra sistem i vetëfinancimit.

Në Trustin e Kursimeve Pensionale deri më tani qytetarët kanë investuar ose kursyer rreth 16 milionë euro, ndërsa vetëm në vitin 2011 kemi kontribute të nivelit rekord prej 108 milionë eurove. Dhe, kthimi në investim për këto 10 vjet, është thënë, është më së paku negativ. Pra, për 10 vjet, jo që nuk kemi kurrfarë kthimi në investim, por realisht kemi zhvlerësim dhe atë shumëdimensional.

Paraja e investuar në Trust tani vlen më pak se që e ka pasur vlerën kur kanë filluar investimet si qytetarë. Nëse për asgjë më shumë, atëherë vetëm për normën mesatare të inflacionit, e cila vlen për vitin 2011 ka qenë 7,3%, sipas Entit të Statistikave të Kosovës.

Më tutje, kostoja oportune e investimit për ne është tani shumë më e lartë, pra krahasimi në përfitim dhjetëvjeçar nëse kishim investuar në ndonjë formë tjetër, gjë që Trusti e injoron tërësisht në kalkulimin e kthimit për investim.

Për më shumë, theksimi i zvogëlimit të taksës menaxhuese, si një rritje e trustit, është jokorrekt, pasi ky vendim merret në Kuvend dhe rrjedhimisht po të mos ishte ky

intervenim nga Kuvendi, kthimi në investim do të ishte edhe më i ulët. Pra, ajo që është edhe më e dhembshme është tendenca për ta mbuluar realitetin e hidhur të kësaj strategjie investuese, me terminologji kontabiliteti për ta projektuar një lloj plani për strategji investuese afatgjate, e cila kinse do të gjenerojë kthim dhe që tani është e qartë që nuk e bën këtë, sidomos në vazhden e krizës financiare.

Pra, Trusti i ka mbledhur 108 milionë euro kursime prej qytetarëve, ndërsa për 10 vjet ka mbledhur 600 milionë euro, të cilat i ka në menaxhim dhe sot na raporton për kthim bruto, pra pa e hequr taksën menaxhuese prej 3,31 milionë eurove. Duke e përkthyer në gjuhën e thjeshtë, do të thotë se Trusti ka pasur kthim në investime 0,5%, pra 1% në shumën e investuar prej 600 milionë euro.

Megjithatë, Trusti këto i konsideron si humbje, pasi sipas tyre këto investime janë afatgjata. Kështu, humbjet e fundit të cilat kanë rezultuar nga kjo strategji investuese paraqiten si të parëndësishme, sepse këto investime janë afatgjate dhe humbjet si të tilla i quajnë të parealizuara.

Për më shumë, nëse shikojmë alokimin e mjeteve nën menaxhim të Trustit, alokim ky i bërë në bazë të politikave investuese të këtij institucioni, pjesa më e madhe është investuar në ekuitete, e që është në shpërputhje me deklaratat se politikat investime të Trustit janë konservative.

Vetëm për faktin se Trusti investon mjete në instrumente afatgjate, nuk mund të thuhet se politikat investive janë konservative. Politikat investive vlerësohen më së shumti duke e shikuar llojin e instrumenteve financiare në të cilat investohen dhe ato që alokojnë shumën e mjeteve në ekuitete. Më së paku mund të cilësohen si konservative, pra do të thotë shuma e tërë mjeteve, e posaçërisht në këtë kohë të krizës financiare.

Ky raport i Trustit thotë se meqenëse performansa e investimeve në këtë periudhë nuk ishte e kënaqshme, mjetet që Trusti i ka në menaxhim për këtë periudhë vazhduan të rriten për 108 milionë euro, pra është fjala për vitin 2011.

Mjetet nën menaxhimin e Trustit gjatë kësaj periudhe janë rritur për çdo muaj rreth afër 9 milionë euro mesatarisht, të gjithë të punësuarit dhe punëdhënësit e Republikës së Kosovës janë të detyruar t'i derdhin kursimet pensionale në llogari të Trustit.

Fakti se mjetet nën menaxhim të Trustit janë rritur për 108 milionë euro nuk shërben aspak për të vlerësuar performansën e këtij institucioni, sepse janë kontribute të qytetarëve e jo pasojë e vendimeve investive apo menaxhimi më të mirë.

Këta miliona euro janë para të qytetarëve, të cilat Trusti e ka për detyrë t'i investojë, e ky investim mund të gjenerojë kthim në investim, nëse për asgjë shumë, atëherë sa për të ruajtur vlerën e parasë në kohë, gjë që nuk po ndodh në këto 10 vjet. Pra, fakti se këto investime po gjenerojnë humbje, falë politikave të gabuara investive të Trustit, na shërben për të vlerësuar performansën e këtij institucioni.

Përfundimisht, Lëvizja “Vetëvendosje” ka disa muaj që e ka prezantuar alternativën për reformën e këtij sistemi të fragmentuar pensional, alternativë e cila do ta zgjidhte si problemin e kursimeve pensionale, po ashtu edhe atë të pensioneve ekzistuese. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të AAK-së, fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

I nderuar zoti kryesues,

Ministra dhe kolegë deputetë,

Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar Raportin dhe në fillim e përkrahim raportin për arsye se e plotëson obligimin ligjor dhe mund të them se për çdo vit është në përmirësim.

Mirëpo, ne do të ndalemi pak më tepër te Bordi menaxhues dhe politikat e tij, për çka edhe është i themeluar. Ata mund të bëjnë disa ndryshime më pozitive rreth Trustit të Kursimeve Pensionale.

Po t'i shikojmë të gjitha të dhënat, del se përmbi 10 vjet nuk ka pasur ndonjë rritje të madhe të mjeteve të investuara me kompanitë, të cilat i ka investuar ky bord menaxhues. Gjithashtu, investimet më të mëdha janë bërë në disa kompani që kanë pësuar humbje, ndërsa investimet më të vogla janë bërë në disa kompani që ka pasur përfitime. Prandaj, detyra e Bordit menaxhues është që t'i shikojë ato kompani, të cilat pritet të kenë investime më pozitive dhe rritje në këto aksione.

Për Grupin e Aleancës, shqetësuese është se me një marrëveshje ndërmjet Trustit të Kursimeve Pensionale dhe Administratës Tatimore të Kosovës nuk do të kishin mbetur mbi 19 milionë mjete pa u definuar për kontribuues, dhe kjo do të ndikonte drejtpërdrejt në kontribuuesit që kanë ndarë mjete për pensione dhe një administrim i Bordit menaxhues të Trustit Pensional me Administratën Tatimore do ta kishte ditur adresën e saktë të punëdhënësit e punëmarrësit dhe të dihet saktësisht dhe në emër të kujt është dhënë ai kontribut. Shpresoj që në të ardhmen ndërmjet këtyre dy institucioneve të zgjidhet ky problem, që është shumë i lehtë për t'u zgjidhur, e jo të mbeten mjetet të padefinuara në Bankën Qendrore të Kosovës mbi 19 milionë euro.

Po ashtu, bordi menaxhues nuk duhet të merret vetëm me taksën, uljen ose ngritjen e taksës, por duhet të ketë politika më të shëndosha rreth investimeve, më tepër duhet t'i bëjnë në Kosovë për arsye se do të kishte të jetë e palogjikshme që ne të marrim kredi me kamata shumë të larta dhe paret tona të shkojnë në vende tjera ku rritja e këtyre investimeve është shumë e vogël. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Koalicioni Kosova e Re, fjalën e ka zoti Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah Raportin në fjalë. Lidhur me përmbajtjen e Raportit folën mjaft kolegë këtu. Unë e shfrytëzoj rastin që gjatë shqyrtimit të këtij raporti të bëj një kërkesë për institucionet përgjegjëse që ta shohin mundësinë e rregullimit të lejimit të tërheqjes së mjeteve të grumbulluara në fond për qytetarin, me qëllim të mjekimit me rastin e ndonjë sëmundjeje të rëndë, e cila konstatohet nga mjekët, para këto pra të deponuara nga individë, nga qytetari dhe mendoj se është e drejtë e tij që t'i shfrytëzojë në momentet më të rënda të jetës së tij.

Me këtë rast, Trusti nuk do të kishte obligime tjera shtesë ndaj qytetarit. Konsideroj se kjo është një e drejtë e qytetarit që duhet të kryhet dhe mendoj se nuk ka asnjë pengesë ligjore për realizmin e kësaj kërkeje. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit, fjalën e ka zoti Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Ky raport vjetor i punës së Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës i përshkruan në mënyrë korrekte aktivitetet e Trustit që janë zhvilluar gjatë vitit 2011.

Raporti përmbledh të gjitha aktivitetet dhe ngjarjet kryesore të vitit, si nga pjesa e investimeve, ashtu edhe nga ajo e operacioneve.

Trusti gjatë vitit 2011 e realizoi një kthim bruto nga investimet në tregjet financiare, një shumë modeste në vlerë prej 3,3 milionë eurove.

Është fakt se viti 2011 ishte sa i vështirë dhe krejtësisht i paparashikueshëm për tregjet financiare. Ngjarjet, si tërmeti në Japoni, trazirat në vendet arabe, e sidomos kriza e borxheve në vendet e Bashkimit Evropian, kanë qenë përmbi interesat e një vendi të vetëm, e aq më pak të një institucioni si ky yni.

Si rrjedhim, vetë qëndrimi i performansës së investimeve të Trustit në kufijtë pozitivë në këto kushte duhet të vlerësohet pozitivisht.

Duhet të përmendet fakti se vlera prej rreth 600 milionë eurove menaxhohet nga një staf i vogël prej 30 e sa vetave, që janë njerëz profesionistë, me një kosto vërtet të ulët financiare, ndoshta edhe vlera më e ulët financiare në Ballkan.

Uroj që gjatë vitit 2012, ky Trust të performojë edhe më mirë në dobi të afërsisht 4 000 hisedarëve që kursejnë nëpërmjet këtij fondi, për të blerë një pension për moshën e tyre të pleqërisë, ata me qëllim që të mos bëhen barrë as e Buxhetit të Kosovës, as e shoqërisë, e as e familjes.

Po ashtu, vlen të përhëndetet edhe fakti që është filluar të investohet edhe në tregun e Kosovës. Rreth 30 milionë i kemi këtë vit. Ne duhet ta inkurajojmë këtë Trust që ta vazhdojë këtë trend dhe ta rrisë shumën e investimeve në vendin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Në sallë janë 67 deputetë. Do ta votojmë Raportin vjetor dhe pasqyrat e të arriturat e Trustit të Kursimeve Pensionale për vitin 2011. Votojmë tash!

Konstatohet se me 54 vota për, 6 kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Raportin vjetor dhe pasqyrat e të arriturve të Trustit të Kursimeve Pensionale për vitin 2011.

Të nderuar deputetë,

Do ta bëjmë një pauzë deri në orën 12:25 minuta. Ju lus që në orën 12:25 të jeni të gjithë në sallë për shkak të seancës solemne, me rastin e vizitës së presidentit të Shqipërisë. Faleminderit!

Pjesa solemne e seancës

(Duartrokitje me rastin e hyrjes në sallë të presidentit të Republikës së Shqipërisë, z. Bujar Nishani)

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,
E nderuara presidente e Republikës së Kosovës, zonja Atifete Jahjaga,
I nderuari kryeministër i Republikës së Kosovës, zoti Hashim Thaçi,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare,
Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues të misionëve diplomatike në Kosovë,
Zonja dhe zotërinj të pranishëm,
Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës,

Mirë se keni ardhur në pjesën solemne të seancës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, me rastin e vizitës së presidentit të Republikës së Shqipërisë, zotit Bujar Nishani në Kosovë.

(Duartrokitje)

Të nderuar deputetë,

Në emrin tuaj dhe timin, presidentit të Republikës së Shqipërisë, zotit Bujar Nishani, i uroj mirëseardhje në Republikën e Kosovës dhe në Kuvendin e saj.

Kjo vizitë e nivelit të lartë është shprehje e marrëdhënieve të ngushta ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, e lidhjeve të shumëfishta ndërmjet dy vendeve, por edhe nevojës së thellimit të bashkëpunimit të ndërsjellë.

Vizita e presidentit shqiptar në Kosovë përbën një rast të mirë për vlerësimin e përparimit dhe zgjerimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve tona, në interes të përbashkët, sepse konsideroj që mund dhe duhet bërë shumë më tepër nga të dyja vendet dhe nga të dyja palët.

Vizita e presidentit të Shqipërisë, zotit Bujar Nishani, e ka edhe një simbolikë të saj të veçantë - se është në përvjetorin e 100-të të shtetit të pavarur të Shqipërisë.

Prandaj, shikuar në këtë rrafsh, kjo vizitë tregon edhe për ecjen gjatë këtyre 100 vjetëve që e ka bërë populli ynë. E ftoj presidentin e Republikës së Shqipërisë, zotin Bujar Nishani, që t'i drejtohet Kuvendit të Kosovës me një fjalë rasti.

(Duartrokitje)

PRESIDENTI I SHQIPËRISË, BUJAR NISHANI:

E nderuar zonja presidente e Republikës së Kosovës, zonja Jahjaga

I nderuar zoti kryeministër, zotëri Thaçi

I nderuar zoti kryetar i Kuvendit, zotëri Krasniqi

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Të dashur qytetarë të Kosovës,

Shkëlqesi ambasadorë dhe përfaqësues të institucioneve të ndryshme, të pranishëm në këtë takim,

Zonja dhe zotërinj,

Pakkush ka nderin dhe privilegjin të flasë nga një foltore kaq e nderuar. Unë jam njëri prej tyre, veçanërisht me fat edhe për disa arsye të tjera: në ditët e para të mandatit tim si President i Republikës së Shqipërisë, në vizitën e parë në këtë post shumë të nderuar dhe në këtë moment fatlum, kur Kosova është plotësisht sovranë dhe e pavarur, kam mundësinë e madhe të marr fjalën në Parlamentin e nderuar të Republikës së Kosovës dhe t'i drejtohem popullit të Kosovës me urimet më të përzemërta për begati dhe prosperitet.

Ju falënderoj ju, të nderuar deputetë dhe kryetarin Krasniqi, që ma bëtë këtë nderim, që përbën një moment kulmor dhe nga më emocionalët të jetës sime.

Përfitoj nga rasti ta falënderoj gjithashtu presidenten e Republikës së Kosovës, për ftesën e saj që ta vizitoj Kosovën dhe për pritjen e mrekullueshme që na është rezervuar.

Së pari, më lejoni që të përulëm me nderim dhe respekt të veçantë për të gjithë ato gjenerata burrash dhe grash që me pushkë e pendë kontribuan në rilindjen e kombit shqiptar, lindjen e shtetit shqiptar që sot mbush 100 vjet, mbajtjen gjallë të dëshirës për liri të Kosovës dhe çlirimit të saj.

Sot nderojmë plot krenari, një nga burrat më të mëdhenj të kombit shqiptar, presidentin e ndjerë Rugova, njeriun që politikën paqësore e ktheu nga një utopi në një mjet të fuqishëm për artikullimin e aspiratave të një populli për liri.

Sot përkulemi më mirënjohje të thellë dhe nderim të madh për Komandantin frymëzues Adem Jashari dhe për të gjithë luftëtarët dhe martirët, që me sakrificën sublime inspiron një popull dhe botës i treguan se për liri shqiptarët nuk njohin kufirin e flijimit.

Mirënjohje pa kufij miqve tanë - Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bashkimit Evropian dhe vendeve anëtare të NATO-s, që bazuar në parimet e humanizmit dhe

vlerat demokratike, vepruan pa hezitim dhe me forcë për të shpëtuar një popull paqedashës dhe liridashës nga kërcënimi i spastrimit etnik.

Vendimi i fundit i Grupit Drejtues Ndërkombëtar për Kosovën, që i dha fund pavarësisë së mbikëqyrur, certifikoi arritjet e mëdha të Kosovës brenda një periudhe kohore të shkurtër në konsolidimin e demokracisë, bazuar në ekonominë e treguat, ndërtimin e shtetit të së drejtës dhe respektimin e të drejtave të njeriut, ndërtimin e një shoqërie multietnike dhe shndërrimin nga një kërcënim në një faktor paqeje dhe stabiliteti në rajon.

Tashmë hapet një kapitull i ri i funksionimit të Republikës së Kosovës, si shtet plotësisht sovran dhe i pavarur, i cili ka të drejtën legale dhe morale për të kërkuar njohjen nga ato vende që ende nuk e kanë bërë një gjë të tillë dhe e meriton të zërë vendin e saj në familjen evropiane dhe institucionet ndërkombëtare.

Angazhohem solemnisht, para jush dhe popullit të Kosovës, se gjatë mandatit tim presidencial, Kosova do të jetë kryefjala e aktivitetit tim, në përpjekjet për shtimin e njohjeve ndërkombëtare, pjesëmarrjen në nismat dhe forumet rajonale, mbështetjen e saj në rrugën e integritetit euroatlantik.

Ju, deputetët e Kuvendit të Kosovës, institucionet, shoqëria civile, keni meritën që Kosova ndonëse e re në moshë si shtet, të mos konsiderohet e tillë, falë pjekurisë së institucioneve të saj. Por, është koha, kur përgjegjësia e gjithë faktorëve të mësipërm të Kosovës është shumë më e madhe.

Në një demokraci parlamentare, parlamenti është zemra e demokracisë, kuvendi ku prodhohen ligjet që vihen në themel të demokracisë dhe shtetit ligjor.

Mbetem thellësisht i bindur se ju do të vazhdoni të gjeni kurajën qytetare për tu ngritur mbi motivet politike dhe të gjeni konsensusin e nevojshëm për çështje në interes kombëtar dhe në interes të qytetarëve të Kosovës.

Me punën tuaj serioze dhe me përkushtimin tuaj, ju do tu shërbeni qytetarëve të Kosovës të çdo etnie dhe përkatësie fetare dhe do të shpërbleni bujarinë, ndihmën dhe përkrahjen e demonstruar nga miqtë tanë, Shtetet e Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe të gjithë miqtë e tjerë, e cila besoj se nuk do të mungojë as në të ardhmen.

Asnjëherë nuk do të harrojmë t'i respektojmë sakrificat, vuajtjet, momentet e mbijetesës. Ata që u flijuan për liri dhe dinjitet. Përmes kësaj kujtese ne shikojmë drejt së ardhmes.

Virtyti i shqiptarëve ka qenë gjithmonë dialogu dhe qasja për komunikim. Ai mbetet mjeti më efektiv për zgjidhjen e problemeve mes fqinjëve dhe projektimit të së ardhmes së përbashkët euroatlantike.

Bazuar në këtë filozofi, Shqipëria mbështet tërësisht bisedimet Kosovë - Serbi për çështjet praktike, si dy shtete të pavarura dhe sovrane, mbështet gjithashtu, vijat e kuqe që ka vënë Qeveria e Kosovës.

Marrëveshjet e arritura duhet të zbatohen qartë, pa ekuivokë, sa më shpejt dhe me garanci ndërkombëtare, që do të sigurojnë pjesëmarrjen e Kosovës në forumet rajonale dhe më gjerë.

Më lejoni të rikonfirmoj edhe njëherë qëndrimin e palëkundur të Shqipërisë, se çështja e statusit të Kosovës dhe e kufijve të saj është një çështje e mbyllur. Shqipëria mbështet plotësisht tërësinë territoriale të Kosovës, në kufijtë e saj aktualë të njohur ndërkombëtarisht.

Fati i qytetarëve të Kosovës është i lidhur ngushtë me forcimin e demokracisë dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës, zhvillimin ekonomik dhe prosperitetin e Kosovës. Duke fuqizuar shtetin e Kosovës, qytetarët e saj garantojnë të ardhmen e tyre dhe të fëmijëve të tyre.

Ne shqiptarët, kemi treguar se dimë të jetojmë në harmoni me fqinjët dhe kemi pasur një bashkëjetesë fetare historikisht harmonike. Për këto arsye, forcimi i faktorit shqiptar duhet parë jo si kërcënim, por thjesht si garanci për paqen dhe sigurinë në rajon.

Shqiptarët do të jenë së bashku në Bashkimin Evropian. Ne shqiptarët, ndonëse të ndarë në disa shtete, kemi një rrugëtim të përbashkët, të vështirë, por vetëm me një alternativë: integrimin evropian. Ne jemi dhe duhet të jemi së bashku në një betejë për të fituar kohën.

Kosova ka mundësinë të shfrytëzojë eksperiencën e Shqipërisë në procesin e liberalizimit të vizave, të përafrimit ligjor me standardet evropiane, në komunikimin me institucionet e Bashkimit Evropian, bashkëpunimin me NATO-n dhe në shumë çështje të tjera. Por, Kosova, gjithashtu, mund të mësojë jo vetëm nga historitë e shumta të suksesit të Shqipërisë në procesin e integritit euroatlantik, por edhe të mos përsëris gabimet e saj.

Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës, bazuar në një vullnet të fortë politik dhe qytetar, do të zhvillojnë një bashkëpunim të ngushtë vëllazëror. Ne kemi ndërtuar kryesisht një infrastrukturë moderne dhe një bazë ligjore të shëndoshë, që garanton lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave, unifikimin e tregut dhe bashkëpunimin në të gjitha fushat. Mbetet të jemi më efektivë në shfrytëzimin praktik të këtyre aseteve.

Të dashur miq,

Të nderuar deputetë,

Ne po festojmë 100-vjetorin e themelimit të shtetit shqiptar, një ngjarje që na mbush me emocione dhe njëkohësisht na bën të bëjmë një bilanc historik.

Pavarësia e Kosovës, anëtarësimi i Shqipërisë në NATO, lëvizja e lirë e qytetarëve në Shqipëri dhe procesi i nisur për qytetarët e Kosovës, arritjet në procesin e integritit evropian, fillimi i procesit të integritit euroatlantik të Kosovës, janë gurë të rëndësishëm kilometrazhi, jo vetëm gjatë 100 viteve të fundit, por në të gjithë rrugëtimin mijëra vjeçar të kombit shqiptar.

Ne kemi potencialet e nevojshme dhe mbështetjen e duhur nga aleatët tanë, për të shpejtuar kohën. Por, gjithçka bazohet në meritë, pra në performansë. Jemi ne ata që e kemi fatin tonë në dorë.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,
Jam i bindur, se ju, udhëheqësit e Kosovës, institucionet e vendit, intelektualët dhe të gjithë qytetarët e saj, pa dallim etnie apo besimi fetar, do ta bëjnë këtë vend më të lirë, më demokratik dhe më të begatë ekonomikisht. Do ta bëni këtë vend një nga kontribuuesit e rëndësishëm të paqes, stabilitetit, bashkëpunimit dhe hapësirave të lira për lëvizje dhe zhvillim.

Zoti e bekoftë Kosovën dhe qytetarët e saj! Ju faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Të nderuar qytetarë,
Të nderuar deputetë,
Zonja dhe zotërinj,
E falënderoj presidentin e Shqipërisë, zotin Bujar Nishani, për vizitën e tij në Republikën e Kosovës, për adresimin me një fjalë rasti deputetëve dhe qytetarëve të Kosovës, si dhe për fjalën e tij të urtë.

(Duartrokitje)

(Vazhdimi i mbledhjes plenare, në orën 15:15)

KRYETARI: Të nderuar deputetë, e vazhdojmë seancën me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve të Komisionit të Pavarur për Media

Dhe, menjëherë pas kësaj e kemi:

3. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media e ka shqyrtuar nominimin e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Të njëjtën gjë e ka bërë edhe Komisioni ad hoc për Bordin e Radiotelevizionit të Kosovës.

Para se t'ia jap fjalën kryetarit të Komisionit, ju njoftoj se në pajtim me nenin 11 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media, me rekomandimet e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media,

Kuvendi duhet të bëjë përzgjedhjen e 5 anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media nga 10 kandidatë të propozuar me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit, që janë të pranishëm dhe që votojnë me votim të fshehtë.

E njëjta gjë vlen edhe për Bordin e RTK-së, meqë duhet të zgjidhen po ashtu 5 anëtarë të Bordit, por ne sot do t'i zgjedhim 4.

Nëse e do fjalën kryetari i Komisionit, le të urdhërojë. Nuk e do!
Atëherë, e kemi një mundësi për ta shkurtuar këtë procedurë. I kemi dy lista për të votuar, për Bordin për Komisionin e Pavarur të Medieve dhe për Bordin për Radiotelevizionin. Ne mund t'i marrim dy lista, njëra e ka ngjyrën e gjelbër, e njëra ngjyrën e bardhë.

Megjithatë, i ftoj kryetarët e grupeve parlamentare të deklarojnë. Fjalën e ka deputeti Adem Grabovci.

(Ndërhyrje)

E kam fjalën për të votuar përnjëherë për dy komisionet.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit kryetar!

Mendoj se për të fituar në kohë, meqenëse janë dy lista dhe dallojnë prej njëra-tjetrës, e kemi Bordin dhe Komisionin, ne propozojmë që të hyjmë në një votim të përbashkët.

KRYETARI: Kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën!

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe ne e përkrahim që ky proces i votimit të jetë në të njëjtën kohë për të dyja bordet, përkatësisht për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, por edhe për Bordin e RTK-së. Domethënë, me një proces të bëhen të dyja votimet për këto dy institucione. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Nga “Vetëvendosja”, kryetari i Grupit, Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Edhe ne pajtohemi që të bëhen njëkohësisht këto dy votime.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti, kryetari i Grupit të AAK-së, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit kryetar!

Edhe ne e mbështetim këtë procedurë të re. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetarja e Grupit Parlamentar Kosova e Re, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit kryetar!

Edhe Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah votimin e dy listave për arsye se njëri është Komision i Pavarur për Media, ndërsa tjetri është Bordi i RTK-së. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka kryetari i Grupit të SLS, Sasha Milosavleviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Samostalna Liberalna Stranka smatra da danas treba da glasamo za Bord RTK-a, a sutra za Nezavisnu Komisiju za Medije. Naravno, da se šalim! I mi smo za to da danas glasamo za oba listića. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i Grupit 6+, deputeti Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar 6+ e përkrah propozimin tuaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë shkojmë me përzgjedhjen e Komisionit të votimit dhe kërkoj nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ta propozojë një kandidat.

ADEM GRABOVCI: Partia Demokratike e propozon Fadil Demakun.

KRYETARI: Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike?

ISMET BEQIRI: Të ju them të drejtën, moti s'e kemi propozuar Armendin që të jetë, prandaj e propozojmë Armend Zemajn.

KRYETARI: "Vetëvendosja"?

VISAR YMERI: Ne e propozojmë Albulena Haxhiun.

KRYETARI: Grupi i AAK-së?

ARDIAN GJINI: E propozojmë deputeten Time Kadrijaj.

KRYETARI: Koalicioni për Kosovë të Re?

MYZEJENE SELMANI: Zonja Sevdije Lama, kryetar!

KRYETARI: Grupi i SLS-së?

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Mi predlažemo Bobana Todorovića.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi 6+?

ALBERT KINOLLI: Duda Balje.

KRYETARI: Faleminderit! Ftoj Komisionin ta zërë vendin e vet.

(Ndërprerje e gjatë e incizimit)

A jeni gati, ju nga Komisioni?

(Ndërhyrje)

Të nderuar deputetë,

Këtu i kemi dy borde. Për Bordin e Këshillit të Pavarur të Medieve sot duhet të zgjidhen 4 veta. Këtu i kemi 3 grupe, e në fakt duhet të jenë 2 grupe. Të merremi vesh! Dhe, Komisioni është dashur ta sqarojë këtë. Ne jemi marrë vesh.

Në grupin e parë, janë 6 kandidatë, zgjidhen 3.

Në grupin e dytë, janë 2 kandidatë, zgjidhet 1.

Këtu është grupi i tretë, duhet të eliminohet. Sepse vendi i pestë është i rezervuar për kandidatin e komunitetit serb. Këtu zgjidhen 5 kandidatë, do të duhej të ishin 5 kandidatë, 3 kandidatë shqiptarë, 2 kandidatë të minoriteteve, njëri i komunitetit serb, tjetri i komuniteteve tjera. Nuk mund të zgjidhen 2 anëtarë të komuniteteve tjera. Prandaj, për anëtarin e komunitetit serb konkursi përsëritet.

Po e sqarojmë edhe një herë...

(Ndërhyrje)

Jo, nuk e kam gabim. Unë jam duke e respektuar atë, për të cilën...

(Ndërhyrje)

Jo, nuk ka kandidat serb këtu.

(Ndërhyrje)

Urdhëro! Prandaj, Komisioni është dashur ta bëjë sqarimin në këtë rast. Regjia, fjalën e ka deputeti Berat Buzhala.

BERAT BUZHALA: Grupi i parë, prej 6 kandidatëve sa janë, zgjidhen 3 shqiptarë, edhe atë meshkuj.

Grupi i dytë, zgjidhet një femër, e kandidate janë Drita Begolli dhe Sadija Nikshiq, e cila e plotëson kuotën e paraparë me ligj për një femër.

Grupi i tretë janë kandidatët e komuniteteve joshqiptare, që nuk janë serbë, e pozita për serb është rishpallur. Është marrë vendim prej komisionit që të plotësohet boshllëku me një kandidat serb, i cili konkurs do të përsëritet prej Komisionit të Pavarur të Medieve.

Pra, plotësohen të gjitha kriteret e parapara dhe të kërkuara me ligj.

KRYETARI: Unë jam dakord me këtë. Pra, nën 3 nuk votohet. Nën 3 nuk votohet dhe kërkoj nga Komisioni që numrit III romak t'i bjerë vijë vetë Komisioni. Nuk votohet!

Të merremi vesh! Prej këtij bordi, 3 kandidatë janë të komunitetit shumicë, - shqiptarë, dhe 2 kandidatë janë të pakicave. Prej pakicave, njëri është i komunitetit serb. Do të thotë, këtë mos e harroni. Nuk mund komuniteti tjetër ta zëvendësojë komunitetin serb. Prandaj, këtë e kemi të qartë. Ne sot e votojmë grupin e parë prej 6 kandidatëve, për 3 kandidatë, grupin të dytë, prej 2 kandidatëve, për 1 kandidat. Nuk ka zgjedhje tjetër sot.

(Ndërprerje e incizimit)

Mirë! Jo, e ka pështjelluar Komisioni, se është dashur ta sqarojë komisioni. Komisioni duhet të dalë ta sqarojë. Ju lutem, në rregull është tash. Edhe prej grupit tre, prej 2 kandidatëve votohet 1; prej grupit dy, prej 2 kandidatëve votohet 1, dhe prej grupit të parë, prej 6 kandidatëve votohen 3.

(Ndërhyrje)

Edhe një herë po e sqaroj këtë. Ju lutem, Parlamenti i ka komisionet për t'i sqaruar këto gjëra, në vend se të merremi ne me to.

Edhe një herë, një sqarim. Për Këshillin e Pavarur të Medieve, prej grupit të parë, nga 6 kandidatë, zgjidhen 3; prej grupit të dytë, nga 2 kandidatë, zgjidhet 1; prej grupit të tretë, nga 2 kandidatë, zgjidhet 1.

Për komunitetin serb shpallet konkursi.

A jeni dakord? Votimi i dytë, fleta e bardhë është për Bordin e Radiotelevizionit të Kosovës. Nga 8 kandidatë, zgjidhen 4, me shumicë të votave.

A jeni dakord? Atëherë, vazhdojmë me procedurën e votimit.

(Ndërhyrje)

Ju lutem, së pari, ia jepni listën deputetit Muhamet Mustafa, sepse ka nevojë të shkojë diku.

Po vazhdojmë!

Deputeti,

Adem Grabovci, Afërdita Berisha-Shaqiri; Afrim Hoti, Afrim Kasolli; Gëzim Kelmendi, Agim Kuleta; Ahmet Isufi, Albana Fetoshi; Albana Gashi, Albin Kurti; Albulena Haxhiu, Ali Sadriu; Albert Kinolli, Alma Lama; Anton Çuni, Arben Gashi; Ardian Gjini, Armend Zemaj; Aurora Bakalli, Azem Sylja; Bahri Thaçi, Arsim Bajrami; Bali Muharremaj, Berat

Buzhala; Behar Selimi, Amir Ahmeti; Bekim Haxhiu, Biserka Kostiq; Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra; Burim Ramadani, Danush Ademi; Daut Haradinaj, Donika Kada-Bujupi; Duda Balje, Elmi Reçica; Emilija Rexhepi, Enis Kervan; Nait Hasani, Eqrem Kryeziu; Etem Arifi, Fadil Demaku; Fatmir Limaj, Fatmir Xhelili;...

...Jeton Svirca, Flora Brovina, Florin Krasniqi, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Goran Marinkoviq, Nijazi Idrizi, Haki Demolli, Halait Krasniqi, Hamza Balje, Hydajet Hyseni Kaloshi, Hashim Deshishku, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Emin Gërbeshi, Idriz Vehapi, Imri Ahmeti, Jakup Krasniqi,...

Drejtimitin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI:

...Jasmina Zhivkoviç, Jelena Bontiq, Justina Pula, Kymete Bajraktari, Latif Gashi, Liburn Aliu, Lirije Kajtazi, Lumnije Morina, Lutfi Haziri, Lutfi Zharku, Fikrim Damka, Kurtan Kajtazi, Suzan Novobërdaliu, Mufera Shinik, Muhamet Mustafa, Mursel Haljilji, Myzejene Selmani, Naser Osmani, Nazane Breca, Kimete Bytyçi, Saša Milosavljević, Petar Miletiq, Rada Trajkoviç, Ramë Vataj, Ramiz Kelmendi, Ramiz Lladrovci, Rasim Demiri, Rexhep Selimi, Rita Hajzeraj-Beqaj, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Sali Asllanaj, Salih Morina, Salihe Mustafa, Sasha Gjokiq, Milivoje Stojanoviç, Sevdije Lama, Shaip Muja, Skender Hyseni, Boban Todoroviç, Sreten Ivanoviç, Teuta Haxhiu, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Ukë Rugova, Vesimir Saviq, Vesna Mikiq, Visar Ymeri, Vjollca Krasniqi, Vjosa Osmani, Valbona Dibra.

A ka dikush që ka ardhur më vonë dhe nuk ka votuar? Nëse jo, atëherë Komisioni le t'i mbledhë letrat dhe ta fillojë punën!

Kryetari i Kuvendit të Kosovës vazhdon me drejtimitin e seancës.

KRYETARI: Armend, e ke fjalën!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Po fillojmë numërimin e votave për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media.

Ju kisha lutur, për të gjithë ata që janë të interesuar dhe për shkak të transparencës, në të tri pjesët e votimit do t'i numërojmë të gjitha, për çdo pjesë, të vlefshme, të pavlefshme dhe se si është rezultati.

Në fletëvotimin

- në pjesën e parë: Ardian Bajraktari, Shefki Ukaj,
- në pjesën e dytë: Drita Begolli,
- në pozitën e tretë, është e pavlefshme, e paplotësuar.
- Pjesa e parë: Ardian Bajraktari, Driton Qeriqi, Xhemajl Krasniqi,
- Pjesa e dytë: Sadija Nikshiq, dhe

- Pjesa e tretë: Nevzat Hydaverdi.

- Pjesa e parë: Shefki Ukaj, Xhemajl Krasniqi,

- Pjesa e dytë: Drita Begolli,

- Pjesa e tretë: e paplotësuar, që do të thotë e pavlefshme.

KRYETARI: Të lutem! Nuk është e pavlefshme, është e paplotësuar!

ARMEND ZEMAJ:

- Pjesa e parë: Emrush Kastrati, Xhavit Shala, Xhemajl Krasniqi,

- Pjesa e dytë: Sadija Nikshiq,

- Pjesa e tretë: Mejdin Saliji.

- Pjesa e parë: Shefki Ukaj,

- Pjesa e dytë: e paplotësuar,

- Pjesa e tretë: Nevzat Hydaverdi.

- Pjesa e parë: Shefki Ukaj, Xhemajl Krasniqi,

- Pjesa e dytë: e paplotësuar,

- Pjesa e tretë: Nevzat Hydaverdi.

- Pjesa e parë: Shefki Ukaj,

- Pjesa e dytë: e paplotësuar,

- Pjesa e tretë: e paplotësuar.

- Pjesa e parë: Ardian Bajraktari, Xhavit Shala, Xhemajl Krasniqi,

- Pjesa e dytë: Drita Begolli, dhe

- Pjesa e tretë: Mejdin Saliji.

- Pjesa e parë: Ardian Bajraktari, Driton Qeriqi, Shefki Ukaj,

- Pjesa e dytë: Sadija Nikshiq,

- Pjesa e tretë: e paplotësuar.

- Pjesa e parë: Emrush Kastrati, Shefki Ukaj, Xhemajl Krasniqi,

- Pjesa e dytë: e paplotësuar,

- Pjesa e tretë: Nevzat Hydaverdi.

- Pjesa e parë: Driton Çarqiqi, Xhavit Shala, Xhemajl Krasniqi,

- Pjesa e dytë: Drita Begolli,

- Pjesa e tretë: Nevzat Hydaverdi.

- Pjesa e parë: Shefki Ukaj, Xhemajl Krasniqi,

- Pjesa e dytë: e paplotësuar,

- Pjesa e tretë: e paplotësuar.

- Pjesa e parë: Shefki Ukaj,
 - Pjesa e dytë: Drita Begolli,
 - Pjesa e tretë: e paplotësuar.
-
- Pjesa e parë: Shefki Ukaj, Xhavit Shala, Xhemajl Krasniqi,
 - Pjesa e dytë: Drita Begolli, dhe
 - Pjesa e tretë: Nevzat Hydaverdi.
-
- Pjesa e parë: Ardian Bajraktari, Driton Qeriqi, Xhavit Shala,
 - Pjesa e dytë: Drita Begolli,
 - Pjesa e tretë: Nevzat Hydaverdi.
-
- Pjesa e parë: Ardian Bajraktari, Shefki Ukaj, Xhemajl Krasniqi,
 - Pjesa e dytë: Drita Begolli, dhe
 - Pjesa e tretë: Mejdin Saliji.
-
- Pjesa e parë: Ardian Bajraktari, Shefki Ukaj, Xhemajl Krasniqi,
 - Pjesa e dytë: Drita Begolli, dhe
 - Pjesa e tretë: Nevzat Hydaverdi.
-
- Pjesa e parë: Shefki Ukaj, Xhemajl Krasniqi,
 - Pjesa e dytë: Drita Begolli,
 - Pjesa e tretë: Nevzat Hydaverdi.
-
- Pjesa e parë: Ardian Bajraktari, Emrush Kastrati, Xhavit Shala,
 - Pjesa e dytë: Sadija Nikshiq,
 - Pjesa e tretë: e pavlefshme.
-
- Pjesa e parë: Shefki Ukaj, Xhavit Shala, Xhemajl Krasniqi,
 - Pjesa e dytë: Drita Begolli,
 - Pjesa e tretë: Nevzat Hydaverdi.
-
- Pjesa e parë: Driton Qeriqi,
 - Pjesa e dytë: e paplotësuar,
 - Pjesa e tretë: e paplotësuar.
-
- Pjesa e parë: Xhemajl Krasniqi,
 - Pjesa e dytë: e paplotësuar,
 - Pjesa e tretë: e paplotësuar.
-
- Pjesa e parë: Emrush Kastrati, Shefki Ukaj, Xhemajl Krasniqi,
 - Pjesa e dytë: Drita Begolli, dhe
 - Pjesa e tretë: Mejdin Saliji.

- Pjesa e parë: Shefki Ukaj, Xhemajl Krasniqi,
- Pjesa e dytë: Drita Begolli,
- Pjesa e tretë: Mejdin Saliji.
- Pjesa e parë: Ardian Bajraktari, Emrush Kastrati, Xhemajl Krasniqi,
- Pjesa e dytë: Drita Begolli, dhe
- Pjesa e tretë: Mejdin Saliji.

- Pjesa e parë: Emrush Kastrati, Xhavit Shala, Xhemajl Krasniqi,
- Pjesa e dytë: Sadija Nikshiq,
- Pjesa e tretë: Mejdin Saliji.

- Pjesa e parë: Shefki Ukaj, Xhemajl Krasniqi,
- Pjesa e dytë: Drita Begolli, dhe
- Pjesa e tretë: Nevzat Hydaverdi.

- Pjesa e parë: Shefki Ukaj, Xhemajl Krasniqi,
- Pjesa e dytë: Drita Begolli, dhe
- Pjesa e tretë: Nevzat Hydaverdi.

- Pjesa e parë: Driton Qeriqi, Shefki Ukaj,
- Pjesa e dytë: e paplotësuar,
- Pjesa e tretë: e paplotësuar.

- Pjesa e parë: Driton Qeriqi, Xhavit Shala, Xhemajl Krasniqi,
- Pjesa e dytë: Drita Begolli, dhe
- Pjesa e tretë: Mejdin Saliji.

- Pjesa e parë: Driton Qeriqi, Shefki Ukaj, Xhavit Shala,
- Pjesa e dytë: Drita Begolli, dhe
- Pjesa e tretë: Nevzat Hydaverdi..

Përndryshe, nëse dikush vazhdon të mendojë se ky zëvendësim i kodeve është komercialisht i pafavorshëm, unë, nga nevoja për ta sqaruar veten, e kam të pamundur të qëndroj pa e pyetur atë: Për kë është i pafavorshëm ekonomikisht shfrytëzimi i një kodi, në vend të tre të tillëve? Për qytetarët? Për Monakon, për Slloveninë e për Serbinë? Apo për një numër të kufizuar individësh? Dhe, përgjigjja e sinqertë në këtë pyetje do ta zbardhte një realitet vërtet të pakëndshëm e të pandershëm.

Këto që thashë mund të tingëllojnë të vrazhda, por e kam të pamundur të ndihem komod kur ndeshem me faktin që kjo situatë e qytetarëve të këtij vendi (e edhe mua, si njëri nga ta) na ka kushtuar dhe po na ka kushton qindra miliona euro humbje, prej përfundimit të luftës e këtej. Këto qindra miliona të humbura janë qindra shkolla moderne të humbura, apo qindra qendra mjekësore të pabëra; janë qindra miliona investime të humbura në infrastrukturë e mbështetje në fushën e bujqësisë, të ekonomisë e të kulturës. Apo, për t'u

shprehur krejt thjesht, me vrazhdësinë e së vërtetës, janë qindra miliona euro që një popull i varfër e krenar i Ballkanit ua fal miliardërve të vuajtur të botës.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Duke i pasur parasysh argumentet që i shpalosa para jush, konsideroj që pesha e tyre është e mjaftueshme për ta pasur të qartë vendimin e drejtë. Prandaj, ju ftoj që ta votoni këtë mocion, sepse në këtë mënyrë, sadopak, do të kontribuojmë që qytetarëve tanë t'uua bëjmë jetën më të lehtë.

I ftoj gjithashtu, në mënyrë të veçantë, ata deputetë që janë të vetëdijshëm se ky hap është shumë i favorshëm për vendin tonë, por që kanë rezerva të natyrave të ndryshme për mundësinë e realizimit të tij, që të përmbahen nga vetëcensurimi dhe ta votojnë atë. Është e drejtë e secilit prej nesh të mos pranojë ta privojë veten nga përpjekja për diçka më të mirë. Është e drejtë dhe detyrë e secilit prej nesh të përpiqemi për ekonomizimin e jetës së qytetarëve tanë. Nëse të tjerët përpiqen të na pengojnë në këtë qëllim elementar, atëherë me vullnet, me vendosmëri dhe nëpërmjet forcës së argumenteve të përpiqemi së bashku ta eliminojmë këtë pengesë.

Sa i përket tekstit të Projektrezolutës, jam përpjekur që ai të mos jetë i ngurtë e joracional. Ajo që kërkohet mendoj se është krejtësisht brenda kornizave të së mundshmes dhe në kuadër të obligimeve që i kemi si institucione për t'u përpjekur për zgjidhje më të mira...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, vazhdoja deri ta kryejë diskutimin.

AGIM KULETA: Prandaj, në këtë frymë, dua ta inkurajoj edhe Qeverinë e Kosovës që të jetë më e guximshme dhe ta bëjë këtë hap për të mirën e qytetarëve tanë. Në qoftë se nuk ka pengesa për Monakon, Slloveninë e Serbinë, kodet e të cilave i shfrytëzon sot Kosova, pse një pengesë e tillë të ekzistojë për Republikën e Shqipërisë? Kriteret e dyfishta nuk duhet të pranohen si të mirëqena, por me vendosmëri dhe argumente duhet të kërkohet që qasja eventuale negative e instancave kompetente për këtë çështje të ndryshohet.

Tani, në vazhdim, ju lutem më lejoni ta lexoj tekstin e rezolutës:

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6, paragrafi 1 dhe të nenit 52, pika 2, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës,

- Duke qenë se Republika e Kosovës ende nuk është anëtare e OKB-së dhe Unionit Ndërkombëtar për Telekomunikacion; e rrjedhimisht nuk mund të ketë kod të vetin telefonik;

- Duke i pasur parasysh humbjet e mëdha financiare (qindra milionëshe), të cilat Republika e Kosovës i ka pësuar dhe i pëson nga shfrytëzimi i kodeve të huaja telefonike: të Monakos, Serbisë, e Sllovenisë;

- Duke e pasur parasysh koston e komunikimit ndërmjet qytetarëve që janë shfrytëzues të kodeve të ndryshme telefonike brenda vendit tonë;

- Duke qenë se lëvizjet e shumta të qytetarëve të Republikës së Kosovës në Republikën e Shqipërisë dhe anasjelltas kanë bërë që intensiteti i komunikimit ndërmjet tyre nëpërmjet rrjetit telefonik të rritet, ndërkohë që kostoja e këtij komunikimi, për shkak të kodeve të ndryshme, është shumë e lartë;

- Duke pasur parasysh mundësinë serioze të cenimit të sigurisë shtetërore;

Në Seancën plenare të datës 30 gusht 2012, e miratoi këtë:

R E Z O L U T Ë

1. Qeveria e Republikës së Kosovës të marrë vendim për zëvendësimin e kodeve telefonike aktuale që Kosova i shfrytëzon (+381, +386 dhe +377), me kodin telefonik të Republikës së Shqipërisë (+355);

2. Në funksion të realizimit të këtij qëllimi, brenda një kohe shumë të shkurtër, t'i iniciojë negociatat me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë dhe

3. Në qoftë se kostoja e shkëputjes së kontratave aktuale valide me ofruesit e kodeve telefonike është më e lartë për vendin sesa respektimi i tyre deri në fund, këto kontrata të zbatohen deri në afatin e paraparë për përfundimin e tyre, por ato të mos vazhdojnë më tutje.

Faleminderit për vëmendjen!

KRYETARI: Qeverinë nuk e kemi këtu. Kryetarët e grupeve parlamentare, në emër të Partisë Demokratike, e do dikush fjalën. Fjalën e ka Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës konsideron që kërkesa për debatin e sotëm për një temë të tillë është një rast i mirë për ta njoftuar opinionin për një çështje të tillë, që është kaq delikate, jo vetëm për përdorimin e kodit të telefonisë, por, në përgjithësi, për zhvillimin e telekomunikacionit në Kosovë, si një segment i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit. Po ashtu, është një rast i mirë për të treguar edhe për disa angazhime që i kanë bërë institucionet konkrete në këtë drejtim dhe për ta pasqyruar gjendjen reale të kësaj fushe.

Është mirë që jo më larg se një ditë më parë e kemi pas në miratim një raport, raportin e Autoritetit Rregullativ të Komunikacionit, i cili merret kryesisht me këtë çështje dhe po ashtu për të gjithë ata që e kanë parë, që e kanë trajtuar këtë raport, e kanë parë se disa

prej informacioneve i kam pasur dhe i kemi trajtuar në atë raport, të cilin edhe e kemi aprovuar.

Çështja e shfrytëzimit të kodit të telefonisë mobile është një çështje më delikate. Ajo i kalon kufijtë e çështjes së telekomunikacionit edhe të këtij biznesi të veçantë. Është edhe çështje politike, për vetë faktin dhe për disa arsye, të cilat i prezantoi edhe parashtuesi i këtij mocioni sot në këtë debat.

Ju e dini se ka qenë dhe mbetet çështje prioritare për institucionet e Kosovës dhe për vetë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, zhvillimi i sektorit të telekomunikacionit, e në këtë drejtim, edhe çështja e sigurimit të kodit thirrës telefonik ndërkombëtar.

Ju e dini se tash më ne kemi nevojë, jo vetëm për ta pasur kodin thirrës telefonik, por edhe kodin shtetëror të internetit që nuk u përmend këtu, e që është një çështje po ashtu jashtëzakonisht shumë e rëndësishme.

Kosova, siç u tha, tani më i shfrytëzon tri kode. Shfrytëzimi i tri kodeve gjeografike shtetërore për telefoni ka shkaktua probleme të shumta në shumë aspekte, që nga zvogëlimi i atraktivitetit për investime në sektorin e telekomunikacionit, pastaj humbjet financiare dhe vështirësitë e mëdha për ta menaxhuar sistemin e numeracionit nga rregullatori dhe operatorët që ofrojnë shërbime të telekomunikacionit në Kosovë.

Të vetëdijshëm për këto humbje dhe për vështirësitë e shkaktuara, autoritetet përkatëse, Qeveria dhe Ministria e linjës, si dhe Autoriteti i Rregullatorit të Telekomunikacionit, si autoritet rregullator nacional, në vazhdimësi e kanë adresuar këtë problem me seriozitetin e nevojshëm në çdo instancë të mundshme, dhe veçanërisht në bashkëpunim me institucionet relevante ndërkombëtare, por deri më tash nuk është regjistruar ndonjë veprim formal, qoftë edhe për paraqitjen e aplikacioneve formale, duke u bazuar në kriteret e caktuara që janë për anëtarësim në këta mekanizma, ku si parakusht kryesor mbetet anëtarësimi i Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Që Kosova ta ketë kodin e vetë telefonik, së pari duhet të anëtarësohet në ITU, që shkurtimisht është organizatë ndërkombëtare përgjegjëse “International Telecommunication Union”, ose në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, pastaj të aplikojë për kodin shtetëror telefonik për anëtarësim në ITU. Pra, ekzistojnë dy mundësi, së pari anëtarësimi në Kombet e Bashkuara, pastaj kërkesa formale për anëtarësim në ITU dhe tjetra anëtarësim direkt në ITU, pa qenë anëtare e OKB-së, ku më parë në këtë rast do të nevojiteshin së paku 2/3 e votave të shteteve anëtare që tash për tash janë 192 anëtarë. Pra, siç dihet, Kosova duhet ta plotësojë këtë kriter për anëtarësim. Hollësi për çështje të kodit shtetëror të telefonisë përmbahen edhe në rekomandimin e ITU-së, E164. Në këtë dokument janë hollësi për aplikim për kriteret dhe për procedurat e marrjes së kodit shtetëror. Sipas pikës 5.2.1, kriteret për ndarje thuhet qartë se vendi aplikant duhet të jetë i njohur nga ITU, ose UN.

Nisur nga fakti se deri më tani Kosovën e kanë njohur vetëm 91 shtete, nënkuptohet se ende mbeten larg arritjet e numrit të nevojshëm për anëtarësim në ITU, sipas skenarit të

dytë. Megjithatë, në këtë aspekt ekzistojnë edhe përjashtime, të cilat janë bërë në momente të caktuara nga ITU si rasti me Palestinën, edhe pse nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara, respektivisht edhe i ITU-së të njëjtës, falë nismës së shteteve përkrahëse të shtetit të Palestinës, i është dhënë mundësia e marrjes së statusit observues në ITU, ku është një referencë e veçantë e zyrtarizuar në vitin 1998 nga ITU, e pasuar më vonë me rezervimin e kodit 970, me mundësinë e caktimit në të ardhmen për autoritetet palestineze. Në këtë drejtim, pra ne na mbetet që të mos i reshtim aktivitetet tona që një rast të tillë të shohim deri në dhënien e plotë të statusit anëtar, ta gjejmë mundësinë dhe rezervimin e këtij kodit tonë të veçantë nga kjo organizatë ndërkombëtare.

ART-ja e ka bërë hapin e parë me hartimin e Rregullores për planin e enumeracionit dhe përmbushjen e kriterëve tjerë që duhen, e cila ka pasur për bazë rekomandimin e ITU-së dhe Ligjin e telekomunikacionit 2002/7 dhe në bashkëpunim edhe me ministrinë kompetente ka punuar dhe është përpjekur që në afat sa më të shkurtër të plotësohen kushtet, të cilat çojnë në marrjen e kodeve shtetërore, me gjithë vështirësitë që janë.

Institucionet përgjegjëse, pra Qeveria dhe Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit, gjatë procesit të dialogut teknik, po ashtu e kanë pasur edhe vazhdojnë ta kenë çështjen e telekomunikacionit si çështje të veten tematike, ku çështja e kodit të telefonisë mbetet njëra prej temave po ashtu për t'u paraqitur edhe alternativa të mundshme për shfrytëzimin e kodeve ose për gjetjen e mundësive për kodet e veçanta, ose kodet shtetërore.

Sa për njoftim, bazuar në ndarjet aktuale të regjioneve nga ITU, Republika e Kosovës i takon zonës së tretë në të cilën aktualisht janë të lira dy kode: 383 dhe 384. Pas sigurimit të kodit, të gjithë operatorët e telefonisë mobile dhe fikse në Kosovë do të jenë të obliguar ta përdorin kodin e ri, pas një periudhe transitore, të cilën do ta përcaktojë Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit. Dhe, siç e thashë, është po ashtu me rëndësi të përmendet se një përpjekje të tillë që duhet të vazhdojë ta bëjë Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit dhe institucionet përgjegjëse, pra bashkë me ministrinë e linjës në krijimin e kushteve ose kërkesat e vazhdueshme në institucionet përkatëse për marrjen e kodit shtetëror të internetit.

Informatat, të cilat na i sjellin, si: raportimet e rregullta, Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit na kanë njoftuar se e ka bërë një tabelë me kërkesa, me disa prej kriterëve, me sugjerimet të cilat i ka dorëzuar në Ministrinë e Jashtme si aktivitete që duhet t'i bëjë Ministria e Jashtme në drejtim të sigurimit të kodit shtetëror të internetit. Një sërë aktivitete, të cilat duhet t'i kryejnë disa ambasada, siç është Ambasada e Republikës së Kosovës në Shtetet e Bashkuara, duke kontaktuar institucionet e Kombeve të Bashkuara dhe po ashtu ambasada jonë në Zvicër, duke kontaktuar ISO- International Standard Organization, që është në Gjenevë dhe po ashtu një varg aktivitete tjerë që duhet t'i kryejë Ministria e Jashtme dhe disa prej të cilave janë në vazhdimësi e sipër sa i përket sigurimit të kodit të internetit.

Dëshiroj të theksoj se si grup parlamentar e inkurajojmë Autoritetin Rregullator të Telekomunikacionit që në këtë fazë, pavarësisht vështirësive që ka, duhet të punojë

ngushtë me autoritetet simotra të shteteve mike, të shteteve të regjionit dhe të shteteve tjera në drejtim të krijimit të miqësive dhe partneritetit me këto shtete në mënyrë që në qoftë se do të ketë ndonjë vonesë më të gjatë, këto shtete do të bëheshin po ashtu edhe partnerët kryesorë në gjetjen e mundësive ose kodeve të tjera të përkohshme, ose do të bëheshin po ashtu edhe ndihmëse, mbështetëse si në rastin e Palestinës, që ne, pavarësisht anëtarësimit në Kombet e Bashkuara, të mund të na jepej një kod i përkohshëm, i veçantë i telefonisë mobile.

Më lejoni po ashtu të përmbledh se pajtohemi që pas këtij debati do të mund ta kishim një rezolutë. Kërkojmë që të bëhen harmonizimet, të jenë në frymën e shqetësimit real që vjen edhe nga parashtruesit e kërkesës për debat për kodin e telefonisë mobile, po ashtu të jetë edhe në frymën e përpjekjeve institucionale të institucioneve të Republikës së Kosovës për arritjen e marrjes së kodit të veçantë për të. Prandaj, jemi në një frymë të tillë nëse duhet të arrihet një rezolutë që të bëjë një kërkesë ose t'i orientohet po ashtu një kërkesë Qeverisë, Autoritetit Rregullativ, t'i intensifikojnë angazhimet e tyre lidhur me sigurimin e kodit shtetëror, apo zëvendësimin e tri kodeve me një kod konform bazës ligjore ekzistuese, mundësive teknike dhe të arsyeshmërisë ekonomike. Pastaj, në funksion të këtij realizimi, të këtij qëllimi, të vazhdojë komunikimi me Republikën e Shqipërisë lidhur me mundësinë e zëvendësimit të kodeve telefonike, si dhe me Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikimit për marrjen e kodit shtetëror ose ndonjë kod i përkohshëm për Republikën e Kosovës.

Në qoftë se kostoja e shpërndarjes së kontratave aktuale, që është një segment shumë i rëndësishëm, i cili ka të bëjë po ashtu me funksionimin e operatorëve aktual, në qoftë se kosto e shpërndarjes së kontratave...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, vazhdoja fjalën deputetit Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: ...aktuale valide me ofertuesit e kodeve telefonike është më e lartë për vendin tonë, këto kontrata të zbatohen deri në afatin e paraparë për përfundimin e tyre dhe të merret për bazë arsyeshmëria financiare për vazhdimin e kontratave me ofruesit aktualë të kodeve telefonike.

Dëshiroj të theksoj po ashtu që duhet të kemi kujdes edhe në kërkesat të cilat i bëjmë. Ju e dini që politikat e këtij Rregullatori janë në frymën e kriterëve të BE-së. Po ashtu, ju e dini që edhe në Raportin e Progresit kemi pasur kërkesa për pavarësi sa më të madhe të këtij autoriteti. Ju e dini po ashtu që operimi ose telekomunikacioni është fushë e pavarur, e cila punon edhe në frymën e standardeve evropiane. Duhet të kemi kujdes që kur të kërkojmë nga Qeveria, të mos kërkojmë diçka e cila është në kundërshtim me frymën e kriterëve të BE-së për funksionimin e kësaj fushe. Ju e dini po ashtu që edhe nëse e kërkojmë një gjë të tillë nga Shqipëria, do të duhej ta kishim po ashtu një proces dialogimi ose negocimi dhe, në anën tjetër, po ashtu, t'i trajtonim edhe kostot financiare dhe çështjet e rëndësishme të leverdisë ekonomike për operatorët ekzistues, e po ashtu për shfrytëzuesit, për qytetarët e telefonisë mobile në Kosovë. Pra, edhe njëherë në emër

të Grupit, ju them që nëse dakordohemi për ta harmonizuar një tekst të rezolutës që do të jetë në këtë frymë, do të jemi në frymën e aprovimit të kësaj rezolute. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputetja Vjosa Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Lidhja Demokratike e Kosovës nuk e sheh të arsyeshme që të debatohet për këtë temë, përderisa ministri i resorit dhe në fakt e gjithë Qeveria po mungon. Kjo injorancë që i bëhet kësaj teme natyrisht nuk është e ditës së sotme, sepse i është bërë edhe gjatë dialogut Kosovë-Serbi, si një çështje që është injoruar tërësisht nga Kosova, në vend se të kërkohet nga Serbia të mos e bllokojë anëtarësimin e Kosovës në ITU, e rrjedhimisht edhe marrjen e kodit telefonik.

Prandaj, ne insistojmë që ministri i resorit së paku të tregojë seriozitet dhe të jetë këtu për ta vazhduar debatin. Faleminderit!

KRYETARI: Kryesia e Kuvendit, me kryetarët e grupeve parlamentare, e kanë bërë agjendën. Agjenda është bërë goxha moti, kështu që si Kuvend ne me kohë e kemi renditur në rend të ditës dhe e themi fjalën tonë, së paku debatojmë.

Është e drejtë juaja, unë fjalën ia kaloj deputetit, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Së pari dua të them që është e vërtetë se është vendosur për këtë debat që të hyjë në rend dite tash e sa kohë dhe arsyeja pse është shtyrë kjo pikë e debatit deri sot është bojkoti që ia bënte seancës së Kuvendit pozita, shumica, siç po e quajnë veten. Pse sot diskutojmë e jo në korrik, është pikërisht pse këta nuk deshën të marrin pjesë në seanca edhe i ikën një teme tjetër, jo kësaj, po e shtyn pastaj edhe këtë.

Çështja e dytë është, natyrisht që është shumë e rëndësishme, që Qeveria, e së paku ministri që e mbulon këtë fushë, të jetë i pranishëm këtu, për shkak se po e diskutojmë një temë e cila është goxha e ndjeshme edhe shumë e rëndësishme në sektorin që ai e mbulon si ministër, pra për të cilën thirret që e mbulon si ministër dhe për të cilën thotë se ‘kam politika, jam duke e marrë seriozisht si temë’ etj., etj., ndërkohë që ai nuk është këtu. Po të kishte qenë fundi i orarit të punës, ndoshta edhe dikush do ta kishte kuptuar, por unë nuk mendoj që Qeveria e kryen punën në orën 14:00 të premtëve, përveç se nëse ka ndryshuar ndonjë gjë.

Çështja tjetër për sa i përket temës për të cilën po flasim, natyrisht janë dy qasje të ndryshme. Dhe këtu e dëgjuam mbulimin e të dy çështjeve, pra ose Kosova do ta ketë kodin e vet, do të insistojë ta ketë kodin e vet dhe ta kryejë punën për ta marrë kodin e vet, ose Kosova do të zgjedhë që ta ketë kodin telefonik të Shqipërisë, ta përdorë kodin telefonik të Shqipërisë për të cilën thërret edhe rezoluta e paraqitur këtu, me të cilën ne si lëvizje “Vetëvendosje” pajtohemi plotësisht. Pra, dua ta them që në fillim këtë tekst të

rezolutës, Lëvizja “Vetëvendosje” do ta votojë, po qe se vjen në këtë seancë deri te votimi, meqenëse po e shoh që nuk ka deputetë të mjaftueshëm as për të diskutuar, e lëre më për të votuar.

Sa i përket...

KRYETARI: Visar, veç një moment! Na e kemi kërkesën e ministrit që ta shtyjme seancën. Nëse ju jeni dakord, ta shtyjme debatin. Debatet janë, kush do mund të marrë pjesë, kush s’do, s’është i obligueshëm. Ju lutem, asnjë kërkesë nuk ishte që ta shtyjme debatin.

VISAR YMERI: Kryetar, së pari këtë kërkesë për ta shtyrë debatin ne po e dëgjojmë tash; e dyta unë nuk thashë që ministri duhet doemos të jetë këtu se nuk mbahet debati pa të, për shkak se e njoh natyrën e debatit, por të paktën një fije të vogël të përgjegjësisë është dashur ta tregojë, që s’po e tregon. Kjo është! Dhe, po vazhdoj me temën, pra nëse më lejohet, natyrisht.

Por, Qeveria nuk e ka injoruar tërësisht këtë debat, do të thosha e ka dërguar këtu një njoftim që përbëhet prej dy faqesh, të cilën e ka dërguar më 6 korrik të vitit 2012, të cilin unë mendoj që më mirë të mos e kishe dërguar fare, për shkak se gjërat që thuhet aty, ose janë gjëra, të cilat tashmë gjithkush i di, pra në këtë letër që e ka dërguar, ose informatë që e ka dërguar Qeveria, thotë që Kosova i përdor tri kode telefonike. Thua ti se qytetarët e Kosovës nuk po e ditkan, e deputetët dhe tash Qeveria po na e tregojnë realitetin, që po i përdorshim tri kode telefonike.

Dhe, në anën tjetër, e përmenda edhe më herët, thuhet në dy ose tri raste në paragrafë që Qeveria e merr këtë me seriozitetin më të madh, këtë çështje dhe pastaj nuk shpjegon fare se ku është ai serioziteti. Edhe elaborimin shumë më të gjerë të kësaj çështjeje, sikur në emër të Qeverisë, e bëri deputeti Zenun Pajaziti. Ndoshta, më mirë atë ta kishim lexuar ne, e jo këtë të Qeverisë.

Dhe, në fund, Qeveria si përgjigje pra për kodin telefonik të Shqipërisë thotë kështu: “Në aspektin teknik kjo mund të realizohet, megjithëse kjo do të ishte zgjidhje e përkohshme dhe do ta kishte koston e saj”. Pra, çka na thotë Qeveria me këto dy pjesë të fjalisë. Në njërin anë, që do të ishte zgjidhje e përkohshme, pra Qeveria në asnjë moment, në asnjë rrethanë nuk e mendon bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, pra e konsideron atë në rastin më të keq, kështu qysh e thotë, se një përkohshmëri, e cila do të ishte si një lloj dergje, që s’kemi qare pa e hequr, përndryshe është sëmundje e rëndë dhe, e dyta, që do të kishte kosto. Thujse situata në të cilën jemi s’ka kosto hiç. Aktualisht, e kemi kodin e Serbisë pa para, kodin e Sllovenisë pa para, kodin e Monakos pa para, e ai i Shqipërisë po na kushtuaka shumë, që natyrisht është aq larg së vërtetës sa që është kjo Qeveri larg realitetit të asaj çfarë ndodh në Kosovë.

Tash po i them disa fjalë për atë se çfarë mendojmë ne për çështjen për të cilën po flasim, edhe pse dorën në zemër shumica prej tyre u thanë këtu edhe nga parashtuesi i kërkesës, edhe nga të tjerët. Pra, nuk kemi nevojë sot që ta bëjmë një elaborim të gjatë të realitetit, për shkak se ai dihet. Nuk kemi nevojë, madje as ta përmendim se nuk është mirë që Kosova edhe katër vjet pas pavarësisë po i përdor këto tri kode telefonike, për arsye edhe

financiare, për arsye edhe strategjike, për arsye edhe të sovranitetit, po edhe për hir të një arsyeje shumë të thjeshtë të simbolikës së të qenët shtet. Për shkak se një gjë ne duhet ta kuptojmë, pavarësia nga Serbia nënkupton pavarësi vetëm nëse pavarësohemi në secilin aspekt të jetës shoqërore dhe publike në Kosovë.

Ndërkohë që pavarësia formale, që nuk e prodhon pavarësimin nga mallrat e Serbisë, nga kodet e Serbisë, nga rrjeti energjetik i Serbisë, nga ndërhyrjet e Serbisë në pjesë të caktuara të territorit të Kosovës, nga ndërhyrjet tjera të Serbisë që i ka, qoftë në institucionet e Kosovës, apo edhe në të tjera, atëherë kjo nuk mund të quhet pavarësi.

Dhe, sa kohë që ne vazhdojmë ta gënjejmë veten, aq më keq do t'i kemi punët në të ardhmen.

Një çështje për sa i përket kodit të telefonisë mobile është se shumë është diskutuar në publik edhe nëpërmjet artikujve të ndryshëm se Kosova i humb 50 000 000 euro, pse i paguan Serbisë për përdorim të kodit telefonik. Disa thonë që i humb më shumë, se kushton më shtrenjtë kodi telefonik i Serbisë, disa të tjerë thonë jo që është 50 000 000 Serbisë, plus një 50 000 000 Monakos, ndërkohë që nga Qeveria nuk ka pasur asnjë informatë zyrtare të shifrës së saktë sa ua paguajmë ne në vit këtyre operatorëve kodin telefonik, të të cilëve e përdorim? Pra, sa para i shkojnë Kosovës në Serbi për këtë kod, sa në Monako dhe sa kushton kodi i Sllovenisë nëpërmjet përdorimit të IPKO-s?

(Ndërhyrje)

Sa?!... Kush po thotë? Aha, ani ju vazhdoni të thoni ashtu... Pra,... më falni për këto ndërhyrje të pavend të rreshtit të parë të Grupit Parlamentar të PDK-së!

Kjo informatë nuk publikohet edhe për një arsye. Unë konsideroj dhe mendoj që është obligim i Qeverisë, të paktën i Kuvendit të Kosovës dhe nëpërmjet Kuvendit edhe opinionit publik t'i kallëzojë se sa shpenzon para Kosova për këtë çështje, për ta ditur pastaj se sa përfitojnë operatorët e ndryshëm, të cilët veprojnë në Kosovë dhe të cilët përfitojnë, qoftë duke vepruar drejtpërdrejt, qoftë në mënyrë indirekte, para të gatshme të Kosovës, që u shkojnë atje vetëm e vetëm për një lloj neglizhence, që e ka treguar Qeveria e Kosovës deri tash në aspektin e kodit të telefonisë mobile.

Për shkak se, u tha këtu, kanë qenë dy mundësi dhe vazhdojnë të jenë dy mundësi. Njëra mundësi është që Kosova të kërkojë aplikim drejtpërdrejt në ITU, ku me 2/3-at e anëtarëve do të merrej, ose nëse ata pranojnë do të anëtarësohej Kosova në ITU, pa qenë e anëtarësuar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe kështu automatikisht do ta merrte kodin.

Por, është edhe një mënyrë tjetër, që ITU-ja ta ndajë një kod për një vend të caktuar pa qenë ai anëtar i ITU-së, e raste të tilla ka sa të duash në botë, nuk po dua t'i përmend, për shkak se nuk janë të rëndësishme, për mendimin tim. E rëndësishme është që ekziston kjo mundësi. Dhe, kjo mundësi madje është përfolur dhe këtë e them është përfolur për shkak se nuk ka verifikim as se ka qenë ashtu, as se nuk ka qenë ashtu, por po dua ta ngre këtu

si debat. Është përfolur që në vitin 2005, ITU-ja kishte vendosur t'ia ndajë Kosovës një kod të telefonisë mobile. Kjo përfolje ka ardhur nga disa burime anonime të UNMIK-ut, të cilat, prapë po e them, nuk ka qenë kurrë të konfirmuara. Pra, mund të mos jetë e vërtetë, por mund edhe të jetë e vërtetë, se kurrkush nuk do ta kishte shpikur këtë prej kokës. Edhe kodi, siç është thënë, atëherë ka qenë ose +889 ose +909, këto dy kanë qenë si opsione. Ndoshta nuk janë të vërteta, por nëse janë të vërteta do të ishte mirë të na tregojë Qeveria se çfarë ndodhi me këto dy kode, ose çfarë ndodhi me këtë vendim, po qe se është marrë?

Edhe mundësia e tretë, që kërkohet me rezolutë, është më e mira, pra që ta përdorim kodin telefonik të Shqipërisë. Për këtë, natyrisht, që pengesa teknike nuk ka, siç e thotë edhe vetë raporti i Qeverisë, apo shkresa e Qeverisë për këtë çështje. Kosto financiare të madhe, të vogël, nuk e di, do të ketë, por nuk është se nuk kemi kosto financiare. Edhe e treta është e rëndësishme dhe është e domosdoshme, për shkak se është edhe mundshme, që ta përdorim një kod të tillë.

Pra, nëse neve na lejohet sot që ta kemi një kod të Monakos, një kod të Serbisë dhe një të Sllovenisë, pse të mos na lejohet dhe pse ne të mos insistojmë që ta kemi vetëm një kod, dhe atë të Shqipërisë? Dhe, ta kemi atë të përbashkët me Shqipërinë. Të merremi vesh me Shqipërinë, siç thotë edhe rezoluta, pra të nisim negociatat me Republikën e Shqipërisë për ta dakorduar marrëveshjen dhe mënyrën e përdorimit, për ta dakorduar koston dhe për ta dakorduar pastaj edhe pjesëmarrjen e Kosovës, si vendimmarrëse për sa i përket kodit, politikave të telekomunikacionit dhe integritit të tregut të telekomunikacionit, në përgjithësi.

Pra, kjo është e mundshme, natyrisht, duhet vetëm vullneti politik. Meqenëse edhe Qeveria po e pranon, edhe PTK-ja ka pranuar disa edhe ART-ja në raportet e veta e pranon, që sa u përket çështjeve teknike kjo është e mundshme, atëherë këtu një mungesë është e vetme, e ajo është mungesa e vullnetit politik, e gatishmërisë politike, për të punuar në këtë drejtim, për ta marrë të drejtën dhe për ta shfrytëzuar kodin e Shqipërisë.

Pastaj, do të mund ta shfrytëzonim kodin edhe në aspekte tjera dhe ky do të ishte një element shumë i rëndësishëm i përafrimit të dyja vendeve, përafrimit në rrafshin e telekomunikacionit, në atë ekonomik dhe pastaj politik. Mirëpo, kur mungon vullneti për t'u përafruar politikisht, atëherë natyrisht që mungon vullneti për t'u përafruar edhe ekonomikisht dhe këto të dyja janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën, siç po na del dhe siç po e shohim për çdo ditë se po ndodh. Ju faleminderit !

Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Xhavit Haliti

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetarja e Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, zonja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Duke marrë parasysh se çështja e këtij debati, siç tha edhe kryetari i Kuvendit, është shtruar kaheerë edhe në mbledhje të Kryesisë, mirëpo prapëseprapë është mirë që po

debatohet, duke marrë parasysh që gjithë qytetarët e Kosovës janë konsumatorë të shërbimeve telefonike dhe shërbimeve të internetit.

Ne e kemi rezolutën që ka ardhur nga ky grup i deputetëve, të cilët kanë kërkuar debat, mirëpo duhet ta shohim gjendjen reale në Kosovë.

Duke marrë parasysh se u tha faktikisht Kosova përdor tri kode të huaja telefonike dhe duke marrë parasysh se Kosova përdor edhe kod të internetit të huajin, atëherë kthehemi nga situata e pasluftës dhe e bëjmë një analizë, duke e parë realitetin me sy.

Në rast se e shohim analizën, atëherë ne e dimë se menjëherë pas luftës çështjet e telekomunikacionit dhe energjetikës kanë qenë çështje të UNMIK-ut dhe në atë kohë, ju e dini mjaft mirë se vetëm Monakoja ka pranuar që Kosova ta ketë një kod telefonik mobil edhe pas kësaj procedure, dihet mjaft

mirë se pas pavarësisë së Kosovës, pas 17 Shkurtit, prapëseprapë gjendja është e njëjtë. Dhe, në rast se shohim pse është gjendja e njëjtë, atëherë duhet ta shtrojmë kërkesën, çfarë kanë bërë qeveritë e kaluara dhe Qeveria e sotme për çështjen e anëtarësimit të Kosovës në OKB dhe në ITU.

U përmend nga shumë parafolës se duhet një numër shumë i madh i shteteve që duhet ta njohin Kosovën, që Kosova të jetë pjesë e ITU-së, apo pjesë e OKB-së. Qeveria së bashku me Kuvendin dhe ART-në duhet të japin mundësinë më të madhe, që t'i kemi kodet e telefonisë, edhe mobile, edhe fikse, dhe kodet e telefonisë, dhe kodet e internetit dhe kodet bankare, për arsye se Kosova dihet mjaft mirë se ka qenë në bisedime teknike me Serbinë dhe, sipas të gjitha gjasave, edhe me Pakon e presidentit Ahtisari ka ngelur çështja e telekomunikacionit si çështje, e cila duhet të diskutohet.

Marrë në tërësi, duhet të shihet me sy ku është problemi dhe si duhet zgjidhur problemi. Në rast se duam t'i kemi kodet e telefonisë nga Shqipëria, atëherë nuk e di se sa do t'i krijojmë problem edhe shtetit shqiptar në ITU, për marrjen e kodeve telefonike të tyre, kur dihet mjaft mirë se ITU-ja është ajo që bën anëtarësimin dhe jep direkt numrat e kodeve prefikse për secilin shtet.

Mbetet në të ardhmen, që Qeveria, ART-ja, Kuvendi dhe gjithë deputetët, gjithë deputetët që janë përfaqësues të popullit dhe ky popull është ai që i shfrytëzon këto kode telefonike me humbje dhe pa humbje, që të mundësojnë që Kosova, në një periudhë shumë të shkurtër, t'i ketë kodet e veta telefonike. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit ! Fjalën e ka deputeti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Me gjithë sensibilitetin e kësaj teme dhe seriozitetin, që shprehet nga një pjesë e deputetëve, por edhe pranisë së Qeverisë dhe të ndërkombëtarëve, mendoj që ne duhet të përkushtohemi seriozisht, sepse kjo është një pjesë, e cila e formëson identitetin e Kosovës.

Kosova është një sukses story, që quhet në bashkëpunim me ndërkombëtarët për të arritur deri sot ku jemi, por edhe kjo që kërkohet sot nga Lëvizja për Bashkim është një storie e suksesit, e cila duhet të plotësohet dhe duhet të na ndihmohet si shtet, sepse i dimë mekanizmat ndërkombëtarë dhe shtetërorë të shteteve, të cilët nuk janë dashamirës të Kosovës, për ta pavarësuar në lidhjet e telekomunikimit.

Nuk është problemi vetëm i telekomunikimit këtu, se sa është kostoja që unë jam dakord me parafolësit tjerë, se sa i kushton kostoja Republikës së Kosovës, por janë edhe mekanizmat tjerë, të cilët në varshmëri, të gjitha shërbimet janë të monitoruara nga njerëz, nga institucionet dhe shërbimet, të cilat nuk ia duan të mirën Republikës së Kosovës. Ne duhet të bëjmë përpjekje dhe duhet të ishte mirë, sot që do të kishim një informacion, i cili do të ishte plotësues nga Qeveria e Kosovës, por në mungesë të saj unë mendoj që Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është përgatitur dhe është solidarizuar me propozimin e Lëvizjes për Bashkim që është i qëlluar, por ne duhet të ndjekim rrugë dhe taktika, me të cilat duhet të arrijnë deri te një pavarësi me kodet shtetërore të Republikës së Kosovës.

Prandaj, një propozim-rezolutë, e cila është bërë nga Grupi i Partisë Demokratike për t'u monitoruar periodikisht qasja e Qeverisë, që u bëhet së bashku me ART-në institucioneve të ITU-së e që ITU-ja ka mundësi, nëse ekziston një vullnet politik edhe i shteteve pjesëmarrëse në ITU, që të na ndihmojnë edhe qoftë në kodin e përkohshëm, e ai të jetë më vonë i përhershëm i Republikës së Kosovës, të plotësohet me këtë rezolutë, e cila është në trepikëshe dhe ne mos të e thërrasim prapë një diskutim parlamentar, që të humbë kohë dhe e cila të jetë në mënyrë periodike çdo tre muaj si raportuese nga Qeveria e Kosovës, se çka është bërë.

Ne kemi bërë shumë lëshime edhe në aspektin me Republikën e Serbisë, për të biseduar në aspektin e shërbimeve teknike. Kjo është një përzierje direkt në çështjet e brendshme të Kosovës, nëpërmjet Republikës së Serbisë, që përdor dhe kodet e veta në mënyrë ilegale dhe bën një evazion fiskal.

Dhe, mendoj që në këtë mënyrë ne duhet të angazhohemi të gjithë, që ta japim një kontribut në hartimin e kësaj rezolute dhe kjo të jetë çdo tre muaj, prapë po e përsëris, raportues Ministria e Ekonomisë së bashku me raportet e ART-së, se çfarë qasjeje është bërë edhe në ITU, edhe në Republikën e Shqipërisë edhe në interferencat politike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Faleminderit!

Mendoj që ai i cili shpenzon minuta të tërë duke u munduar të thotë se Kosovës i duhet vetëm kodi i vet i pavarur, kurse, në anën tjetër, po ashtu na bind se sa e vështirë kjo është, që Kosova ta ketë kodin e vet të pavarur, e në anën tjetër kurrkund nuk e përmend Republikën e Shqipërisë, kjo është shumë kollaj ta kuptoj se çka po duam të themi. Kjo është që të jesh avokat i status quo-s, të vazhdojë kjo gjendje, në të cilën jemi, por debati po mendoj se nuk po shtrohet kështu. Debati i vërtetë nuk është se sa e vështirë është ta kemi kodin tonë, sepse procedurat u cekën. Kjo është shumë e vështirë, të jesh anëtar i

OKB-së, t'i kesh 2/3 e votave të të gjitha shteteve. Kjo merr kohë, e ne e dimë se në çfarë faze jemi.

Debati është shumë më i thjeshtë: A me Shqipërinë, a me Serbinë? Ky është debati. Dhe unë mendoj që është shtruar shumë mirë edhe në mocion, sepse kjo problematikë duhet të trajtohet nga dy aspekte, dhe ato u përmendën tashmë: nga aspekti ekonomik dhe nga aspekti i sigurisë. Nga aspekti ekonomik, dobia është e pakontestueshme, sepse po ta merrnim kodin telefonik fiks të Republikës së Shqipërisë, për shtetin tonë do të kishte shumë pozitiv ekonomik.

Deri tash, pikërisht ngaqë kemi qenë dhe vazhdojmë të jemi nën kodin e telefonisë fikse serbe, ne kemi humbur së paku qindra miliona euro, nëse deri tash nuk janë bërë miliarda.

Kjo do të thotë se politika jonë deri tash ka qenë shumë e leverdishme ekonomikisht për Serbinë. Prandaj, do të punojmë që kjo të ndryshojë, e jo të vazhdojë kështu siç është.

Po të lidheshim me Republikën e Shqipërisë në aspektin e telefonisë fikse, atëherë kjo nuk ka kosto, sepse shumë lehtë do të mund të bëhej një marrëveshje me Republikën e Shqipërisë, që shuma, nëpërmjet së cilës fitohet ekonomikisht prej kodit telefonik të lidhjes së Kosovës me Shqipërinë, me një marrëveshje shumë të thjeshtë, t'i vijë drejtpërdrejt Republikës së Kosovës, Kjo punë zgjidhet kollaj. Nuk është ndonjë farë filozofie. Duhet pasur zemër e vullnet, dhe bëhet.

Po ashtu, mendoj se në aspektin e sigurisë, çështja është edhe më skandaloze. Pse? Për arsye se me këtë sistem të telefonisë fikse që e kemi, Serbia bëhet kontrolluese e drejtpërdrejtë e informacionit të qytetarëve të Kosovës. Dhe, besoni, jo vetëm e qytetarëve të Kosovës, por e institucioneve, e informacionit, e bisedave që i zhvillojnë institucionet edhe me vendet e jashtme, edhe kur një politikan, një zyrtar i lartë flet me telefon fiks, me një homolog të tij ndërkombëtar, kjo është potencialisht e kontrollueshme nga Serbia.

Dihet shumë mirë që në kohën tonë, informacioni është arma më e fuqishme e strategjisë kombëtare. E ne këtë aset ia kemi dhënë një shteti, pra këto informata po ia japim në dispozicion një shteti, i cili çdo informatë, bash çdo informatë, e shfrytëzon për ta shkatërruar dhe për ta luftuar sovranitetin dhe pavarësinë tonë.

Po ashtu, mendoj se me këtë rast duhet të shtrohen disa pyetje. Kujt i konvenon që informatat, pra nëpërmjet telefonisë fikse, të kontrollohen nga Serbia? Dikur thoshim që kjo i konvenonte UNMIK-ut, për shkak të Rezolutës 1244, për shkak se UNMIK-u nuk e pranonte pavarësinë e Kosovës e të tjera. Por, tash kur po themi se UNMIK-u nuk është, nuk ekziston më si pushtet, dhe se jemi të pavarur nga viti 2008, kujt po i konvenon kjo gjendje? Kur një zyrtar yni flet me telefoni fikse me ndonjë homolog të tij ndërkombëtar, më përpara e merr vesh Serbia se qytetarët e Kosovës, se populli i Kosovës! Më përpara e di çka është zhvilluar në atë bisedë Serbia, sesa e di krejt çka është folur qytetari i Kosovës dhe populli i Kosovës, e mendoj se kjo nuk është në rregull.

E njëjta, siç u përmend edhe këtu, ndodh edhe me çështjen e internetit, sepse lidhjen, ndonëse e marrim prej Maqedonisë, Maqedonia e merr prej Serbisë dhe Serbia në këtë mënyrë, jo vetëm që po bëhet kontrolluese e informatave në mënyrë telefonike, por edhe në mënyrë elektronike. Dhe, kjo është shumë e dëmshme për sigurinë e shtetit të Kosovës.

Në anën tjetër, të mos harrojmë se nëpër disa prej enklavave dhe në veri të Kosovës kemi uzurpim, jo krijim të rrjetit paralel të Serbisë, por uzurpim të rrjetit të Republikës së Kosovës - të telefonisë fikse. Pra, nuk është rrjet paralel. Ky është uzurpim i rrjetit të Kosovës, i cili shfrytëzohet nga Serbia. Dhe, për këtë arsye nuk është e rastësishme që çështja e telekomunikacionit vazhdimisht përfundon me negociata me Serbinë, pikërisht për këtë arsye. Sepse, ka kyçje ilegale të telefonisë serbe në rrjetin fizik të Kosovës, e cila shfrytëzohet prej Serbisë.

Dhe, të mos harrojmë që tani na vjen situata kur, e mbani në mend planin e 6-pikëshit të Bank Ki-Munit të famshëm, aty te telekomunikacioni ka qenë pikë, për të negociuar pikërisht për këtë arsye. Dhe, në mënyrë që këto probleme të mos na ndodhin edhe më tutje, kjo do të ishte edhe një mundësi e mirë që të fillonte shpërbërja e strukturave kriminale të Beogradit. Më së miri do të ishte që të fillohet nga këto të telefonisë, e të shkohet deri te ato të sigurisë.

Kështu, unë u bëj thirrje edhe deputetëve tjerë që ta votojnë këtë mocion, që të lidhemi me telefoninë fikse me Republikën e Shqipërisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Hydajet Hyseni!

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Nuk do ta merrja fjalën, se që të jem i singertë është një fushë në cilën unë nuk kam njohuri të duhura, nuk e kam as informacionin e duhur dhe nuk dua “të hyj në mal pa sakicë”.

Por, megjithatë, nuk duhet të jesh shumë i informuar, as shumë profesional, për të vlerësuar se është një nismë e drejtë, krejt e ligjshme, krejt e natyrshme, e cila nuk mëton ta absolvojë tërë çështjen, por e inicion, kërkon prej Qeverisë ta hulumtojë një rrugë për zgjidhjen e çështjes së pazgjidhur për Kosovën, ose të zgjidhur keq. Nuk duhet të jesh shumë as i informuar, as profesionist, për të parë që nëse një praktikë është kah zbatohet me një shtet, me shtetin e dytë, me shtetin e tretë - pse të mos mund të shikohet mundësia për ta rregulluar edhe ashtu siç është propozuar.

Kam pritur që Qeveria, së paku, të jetë e pranishme, dhe të japë përgjigjen e saj këtu. Tash u njoftuam me vonesë se ministri nuk është këtu, e ka kërkuar që seanca të shtyhet. Kjo është edhe çështja që më shtyri ta marr fjalën.

Në raste të tilla, propozimi i deputetëve duhet të hidhet në votim. Ne nuk e kemi kuorumin për ta hedhur në votim, prandaj propozoj, siç edhe është propozuar, që ky debat të mos përmbyllet në këtë mënyrë. Të lihet që sipas kërkesës së ministrit të bëhet kur të jetë i pranishëm edhe ai, që ta japë qëndrimin e vet. Besoj se do të ishte, siç u tha këtu, në parim dakord. Do të shihet mundësia për ta realizuar këtë kur të krijohen kushtet dhe në

këtë mënyrë të përmbillet kjo çështje. Besoj se kjo do të duhej të ishte bërë edhe në fillim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gërbeshi, i fundit e ka fjalën!

EMIN GËRBESHI: Faleminderit, kryesues!

Edhe unë e mbështes mocionin. Është një kërkesë legjitime, është një kërkesë e drejtë, për arsye se është dashur që Kosova që moti ta dëshmojë se po e ndërton shtetin e vet, të shkëputet nga e kaluara, të shkëputet tërësisht, bile të paktën nga një kod i Serbisë, në mos nga dy kodet tjera. Po edhe nga dy kodet tjera që i përdor për telefoninë mobile ka pasur mundësi ta bëjë këtë. Në bazë të informatave që i kam, nuk ka pasur ndonjë angazhim shumë serioz që Kosova të paktën ta fitojë të drejtën e përdorimit të një kodi ndërkombëtar. Nuk ka pasur përpjekje as që Kosova ta ndërrojë kodin dhe të kthehet nga Shqipëria, por ka ekzistuar kjo formë e tillë që, de fakto, na ka vënë para një situatë dhe kemi ardhur deri në momentin që në Parlamentin e Kosovës të vijë deri te një mocion dhe të kërkohej të lidhemi me kodin e Shqipërisë.

Është shumë interesante që ka vite të tëra që kjo çështje nuk është ngrehur, nuk është diskutuar në instanca të larta, as qeveritare, as të Parlamentit, dhe është shumë e pritur që pikërisht të ngrihet në këto momente, prandaj unë mendoj që ne duhet të pranojmë që në pamundësi që Kosova ta ketë kodin e vet, bile të paktën ta shfrytëzojmë kodin e Shqipërisë dhe të mos i krijojmë profit tjetërkujt, pa pasur pikë interesi. E dimë që telefonja dhe vetë kodet janë profitabile. E dimë që pa prekur interesat, edhe të ndërkombëtarëve, edhe pa prekur interesat, besa edhe të vendorëve këtu, e grupeve të caktuara, kjo nuk mund të bëhet, por kjo iniciativë shumë e qëlluar duhet të përkrahet, jo vetëm nga deputetët, por edhe nga i gjithë populli i Kosovës. Dhe deputetët, populli i Kosovës dhe Qeveria e Kosovës duhet ta dëshmojnë edhe një herë se tërësisht duhet të shkëputemi nga e kaluara dhe nga lidhjet me Serbinë dhe ta ndërtojmë një pavarësi tamam ashtu siç edhe po pretendojmë ta ndërtojmë, nëse e kemi përnjëmend të ndërtojmë shtet.

Varësia nga telefonja dhe nga kodi i Serbisë është tepër e çuditshme dhe në këto momente është tepër e papranueshme. Bile, të paktën, nëse nuk është bërë deri më tani, të bëhet tash.

Serioziteti që po e tregon Qeveria në këtë raport është tepër interesant, por po shpresoj që njerëzit do të vetëdijesohen, do të ndërgjegjësohen, ose, në fund të fundit, do ta pranojnë se kanë interesa që kodi telefonik i Serbisë ende të funksionojë, e të mos lidhemi me kodin e Shqipërisë. Në të kundërtën, ne do të kërkojmë me këmbëngulje që ky mocion të votohet, të kalojë dhe të paktën ta shfrytëzojnë këtë kod - kodin e Shqipërisë. Unë do ta përkrah këtë mocion. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe pse thashë - i fundit, Albin u lajmërova pak me vonesë pak. Merre edhe ti fjalën.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Brezi frekuencor dhe numeracioni janë attribute të sovranitetit të një shteti. Edhe në këtë aspekt, Kosova e pavarur nuk është sovranë. Serbia, në njërin anë, dhe Monako e Sllovenia, në anën tjetër, janë instancat sovranë, të cilave ne u paguajmë qira në vendin tonë.

Gjatë këtyre 13 vjetëve të pasluftës, nga Kosova në këto tri vende kanë shkuar qindra miliona euro për shkak të prefiksit telefonik që ne ua kemi huazuar atyre.

Pra, së pari, ne nuk jemi vetja jonë dhe, së dyti, ne shfaqemi si dikush tjetër, për çfarë detyrohemi të paguajmë. Mungesa e sovranitetit nuk përkthehet vetëm në cenim të dinjitetit, por edhe në kosto materiale.

Buxheti i shtetit të Kosovës është më i vogël për shkak se nuk jemi sovran. Dhe, vlera e aseteve tona është më e vogël sepse i përkasim një shteti josovran.

Meqenëse Kosova nuk njihet nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, dhe përderisa nuk njihet nga OKB-ja, ajo gjithsesi do të mund të bisedonte me Shqipërinë, ta bënte një dialog edhe teknik, edhe politik, dhe të pajisej me kodin +355.

Ne jemi një, ne jemi një komb, dhe kësaj do të mund t'i shtonim përmbajtjen edhe në këtë fushë: kombi nuk është vetëm kulturë, gjuhë, traditë e histori, por kombi është edhe politikë, institucione dhe ekonomi kombëtare.

Mirëpo, nuk kam dyshim se Qeveria e Kosovës, jo vetëm që nuk ka vullnet politik për këtë çështje, por ajo nuk ka as interes që Kosova ta ketë kodin telefonik të Republikës së Shqipërisë. Madje, kjo Qeveri nuk ka vullnet pikërisht për shkak se nuk ka interes.

Sigurisht që bashkimi me Shqipërinë nuk po ndodh për shkak se mungojnë hapat integruar me Shqipërinë. Mirëpo, para se të mbërrijmë këtu, vetë hapat integruar të Republikës së Kosovës me Republikën e Shqipërisë mungojnë, meqenëse mungon intenca për bashkim kombëtar. Pra, nuk është çështja që nuk po e arrijmë qëllimin, sepse s'po bëjmë hapa, por s'po bëjmë hapa, sepse është braktisur qëllimi.

Aktualisht nuk ka integrim të Kosovës me Shqipërinë, sepse ka lejim të Serbisë në Kosovë. Kur lejohet Serbia në Kosovë, në ekonomi, në politikë, me mallrat e strukturat e saj ilegale, natyrisht që integrimi me Shqipërinë ka pengesa të shumta e të shtuara. Sa më e varur dhe më e lidhur Kosova me Serbinë, aq më e larguar prej Shqipërisë mbetet ajo.

Konjuktura politike në pushtet në Kosovë është pasuruar dhe forcuar duke qenë Kosova e ndarë nga Shqipëria. Prandaj, kjo konjunkturë - që me hegjemoninë e saj aspirojnë të shndërrohet në shtresë shoqërore dominuese - nuk ka interes për integritet me Shqipërinë. Reflektim i këtij rendi është qëndrimi politik se ka kaluar koha e patriotizmit, se patriotizmi e nacionalizmi i përkasin një mentaliteti të së kaluarës dhe se këto janë çështje që bien në regjistrin e romantizmit. Ky qëndrim buron nga interesi partikular dhe ligjërimi publik i tij synon të shndërrohet në legjitimitet. Pra, nuk besoj që botëkuptimi kundër patriotizmit i paraprin interesit partikular, por e kundërta: janë interesa të caktuara

në pyetje, të cilat sjellin mendime të këtilla që shndërrohen në legjitimitet posteriori për këto interesa të veçanta.

Teksa ne flasim në Kuvend se si Kosova duhet ta marrë kodin telefonik të Shqipërisë, në Qeveri po flasin se kujt do t'ia shesin PTK-në. Këta, jo vetëm që nuk po na bëjnë sovranë si shtet e si komb, por edhe po na shpronësojnë si publik e si qytetarë.

Prandaj, beteja jonë në këtë rast nuk duhet të kufizohet vetëm te prefiksi kombëtar, por edhe te pasuria kombëtare e publike, siç është PTK-ja, te mbrojtja e PTK-së. Sepse, teorikisht, mund të thuhet se, edhe mund ta marrim ndonjë ditë në të ardhmen disi prefiksin e Republikës së Shqipërisë, në ndërkohë që këta e kanë shitur telekomunikacionin e Kosovës si kapacitet, si aset, dhe fitorja e tillë do të ishte, siç thotë populli ynë, një zero me xhufkë.

Prandaj, krahas hapave në drejtim të bërjes së Kosovës sovranë në fushën e telekomunikacionit, ne do të duhej ta mbrojmë atë pasuri që e quajmë telekomunikacion.

Kjo Qeveri, sikur edhe ajo paraprake, nuk e ka bërë asnjë angazhim të vetëm për ta hequr nenin 1.3 të Kushtetutës së Kosovës, që na e ndalon bashkimin me Shqipërinë. Ndryshimet e dëshiruara të Kushtetutës nga kjo Qeveri janë për poste në pushtet, siç është ai i Presidentes, e jo për sovranitet të shtetit, i cili gjymtohet nga neni 1.3. Sepse, kjo Qeveri, për bindjen time, nuk ka mendësi kombëtare e moderne, por krahinore e feudale. Ministrat dhe kryeministri i Kosovës duan të jenë e të duken në paritet me kolegët e tyre nga Republika e Shqipërisë. Duan të duken si dy - ndaras dhe jo si një - të bashkuar. Ndërkohë që ne duhet të jemi një dhe nuk mund të jemi dy. Sepse, nëse jemi dy, atëherë, në të vërtetë, jemi dy gjysma, jemi gjysmë. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Kërkoj falje! Nuk mund ta nxjerr në votim, nuk ka kuorum, prandaj mbetet për seancën e ardhshme. Janë 51 deputetë në sallë, kështu që votimi është i pavlefshëm. Faleminderit dhe mirupafshim!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë